# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Qeveria – Vlada – Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

# UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.32/2024
# PËR MASAT DHE KRITERET E PËRKRAHJES PËR ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2024

[1] Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr. 32/2024 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2024 i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 17.12.2024.

**Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,**

Në mbështetje të Nenit 8 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, paragrafi 5, nenin 15 paragrafi 7 dhe nenit 21 paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/29 Mars 2023), Nenin 14 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta Zyrtare Nr.26/29 Dhjetor 2023), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/18 Nëntor 2022) si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK)-NR.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06.2024),

Nxjerrë:

# UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.32/2024 PËR MASAT DHE KRITERET E PËRKRAHJES PËR ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2024

## KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen parimet, kushtet, procedurat, kriteret e pranueshmerisë dhe kriteret e përzgjedhjes për zbatimin e masave të Programit të Zhvillimit Rural, të miratuara për vitin 2024.

### Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, aplikuesit dhe përfituesit nga Masat e Zhvillimit Rural.

2. Ky Udhëzim Administrativ përcakton përkrahjen për masat dhe nën-masat e Programit për Zhvillim Rural (PZHR) 2024.

### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

   1.1. **“MBPZHR” -** nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

   1.2. **“ARBK**”- nënkupton Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë;

   1.3. **“AZHB” -** nënkupton Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë,

1.4. **“PZHR 2024” –** nënkupton Programin për Zhvillimin Rural për vitin 2024;

1.5. **“Masa 1” -** nënkupton investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore**;**

1.6. **“Masa 3”** - nënkupton investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;

1.7. **“Masa 5” -** nënkupton përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore lokale - Qasja LEADER;

1.8. **“Nën - masa**” - nënkupton nën sektorin i cili e ka buxhetin e caktuar/ ndarë;

1.9. “**Thirrja për aplikim” -** nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve;

1.10. **“Aplikues” -** nënkupton personin fizik apo juridik, i cili aplikon për të përfituar projekt në PZHR 2024;

1.11. “**Aplikacioni” -** nënkupton formularin e plotësuar për aplikim me të gjitha dokumentet e kërkuara nga AZHB;

1.12. “**Projekt**“ - nënkupton dokumentin që parasheh investimin e planifikuar për përkrahje nga PZHR 2024, të dorëzuar nga aplikuesi;

1.13. “**Përzgjedhja” -** nënkupton selektimin e projekteve sipas pikëve të renditura;

1.14. **“Kriteret e përzgjedhjes” -** nënkupton kriteret që përcaktojnë prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuara në analizën SWOT dhe objektivat e përcaktuara në PZHR 2024;

1.15. “**Përfitues” -** nënkupton personin fizik apo juridik, i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikimit, nënshkrimit të kontratës dhe financimit të projektit nga MBPZHR;

1.16. **“Shkalla e përkrahjes publike” -** nënkupton kontributin nga buxheti publik për zbatimin e projektit;

1.17. **“Kontrata”** - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të përfituesit dhe AZHB-së për zbatimin e projektit të përfituar;

1.18. **“Shpenzimet e pranueshme”** - nënkupton shpenzimet që përkrahen me mjete financiare;

1.19. **“Pemë drufrutore” -** nënkupton molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, gështenja dhe ftoni;

1.20. **”Pemë manore” -** nënkupton dredhëza, mjedra, manaferra, boronica dhe aronia;

1.21**. “Periudha e zbatimit të projektit**” - nënkupton periudhën për zbatimin e projektit të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe kontratën e nënshkruar mes përfituesit dhe AZHB-së;

1.22. **“Kërkesa për pagesë”** - nënkupton parashtrimin e kërkesës për pagesë për shpenzimet e pranueshme, të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit;

1.23. “**Ex-post kontrolli” -** nënkupton kontrollin në terren të investimeve pas zbatimit të projektit të bashkëfinancuar nga Programi i Zhvillimit Rural nëse projekti është duke ju përmbajtur kushteve të kontratës të lidhura mes AZHB-së dhe përfituesit;

1.24. **“NIF” -** nënkupton Numrin Identifikues të Fermës;

1.25. **“Ferma”-** nënkupton njësinë prodhuese në aspektin teknik dhe ekonomik e cila menaxhohet nga fermeri në të cilën zhvillohen aktivitete bujqësore dhe aktivitete të zhvillimit rural;

1.26. **“Zgjerimi”-** nënkupton zgjerimin e objektit ekzistues;

1.27. **“Rinovim”-** intervenimi për përmirësim të objektit ekzistues.

**Neni 4**
**Masat e përkrahura**

1. **Masat e përkrahura janë:**

    1.1. Masa 1 - Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore;

    1.2. Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;

    1.3. Masa 5 - Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - Qasja LEADER.

    1.4. Masa e menaxhimit të rrezikut në bujqësi - Sigurimet Bujqësore.

**Neni 5**
**Shtrirja gjeografike**

Programi i Zhvillimit Rural 2024 përfshinë tërë territorin e Republikës së Kosovës.

## Neni 6
## Kriteret e përbashketa për masa

1. Këto kritere vlejnë për Masën 1 - Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore dhe Masën 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

1.1. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre si dhe t'i mbajnë të gjitha dokumentet sipas projektit të miratuar, gjatë pesë (5) viteve pas datës së ekzekutimit të pagesës, aq sa zgjatë periudha monitoruese dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së, AZHB-së, auditorit, organizatave dhe institucioneve te tjera me kërkesë të AZHB-së.

1.2. Kërkesa për pagesë refuzohet për projekte të cilat nuk kanë finalizuar ndonjë aktivitet për të cilin është poentuar gjatë procesit të vlerësimit.

1.3. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L – 072 për Bujqësi dhe Zhvillim rural;

1.4. Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2024 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar;

1.5.Në rast se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja, ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.6.Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në (5) pesë vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, zyrtarët vlerësues të projektit e shtypin letër-informimin për miratimin e atij projekti dhe me rastin e kontrollit të parë në terren, inspektorët së pari e kontrollojnë projektin e viteve paraprake. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe/ose nuk është funksional, nuk mund të lidhet kontrata e re;

1.7.Të gjithë përfituesit të cilët në planin e biznesit të tyre kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë përfituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimet në paga, duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit;

1.8.Përfituesit janë të obliguar të mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë, për aq sa zgjatë periudha monitoruese;

1.9.Në rast se në ekonominë familjare të aplikuesit haset edhe një ose më shumë NIF-a të tjerë, përveç atij të aplikuesit, atij i kërkohet pasivizimi i NIF-ave tjerë, në të kundërtën refuzohet aplikacioni;

1.10. Të dhënat e NIF-it duhet të jenë të përditësuara. Të gjitha asetet, për të cilat ka rubrikë të veçantë në certifikaten e fermerit, duhet të jenë të regjistruara në NIF;

1.11. Aplikuesi nuk mund të përfitoj një projekt nëse është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;

1.12. Zbatimi i projektit /fillimi i investimeve mund të bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pagesa e ndihmës publike do të bëhet në bazë të kërkesës për pagesë dhe kushteve të kërkuara në kontratë;

1.13. Pagesa mund të bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin me kërkesën e tij (përveç nëse është e caktuar ndryshe në masa), me kusht të sigurimit të garancionit bankar (nga institucionet bankare dhe kompanitë e sigurimeve), ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;

1.14. Nëse përfituesi nuk bënë kërkesë për paradhënie atëherë pagesa e tërësishme bëhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;

1.15. Kerkesa për pagesën e avansit duhet të bëhet jo me larg se **30** ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës;

1.16. Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;

1.17. Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar;

## 2. Kërkesat e aplikimit për mbështetje

2.1. Kërkesat e përgjithshme në vijim zbatohen, përveç nëse kërkohet ndryshe në përshkrimin e masës:

2.2 Të gjithë aplikuesit që aplikojnë për mbështetje nga PZHR duhet të dorëzojnë formularët e aplikimit përmes aplikimit online të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për masa të veçanta dhe të kompletojnë dokumentet e kërkuara;

2.3 Në aplikacion duhet të përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e pranueshme lidhur me projektin për të cilin aplikohet;

2.4 Aplikuesi mund të aplikojë në masa të ndryshme të programit. Megjithatë, aplikuesi mund të aplikojë vetëm një herë brenda masës/nën-masës brenda një afati/thirrje për aplikim të atij viti;

2.5 Nëse aplikacioni aprovohet, aplikuesi duhet të përfundojë këtë projekt para se të aplikojë për projektin tjetër;

## 3. Kushtet për zbatimin e masave të PZHR përveç nëse thuhet ndryshe në masën specifike

3.1 Në rastet kur me projekt parashihet ndërtim apo zgjerim të objektit, aplikuesit duhet të dorëzojnë skicat e projektit ideor dhe koston e vlerësuar të punimeve dhe materialeve të parashikuara/parallogaritë e shpenzimeve;

3.2 Aktivitetet e ndërtimit/ rinovimit/ zgjerimit duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara të Komunës në përputhje me planet urbane dhe hapësinore apo standardet tjera të aplikueshme të Komunës;

3.3 Aplikuesi i cili aplikon për ndërtim/zgjerim apo rinovim te objektit, përmirësimin e ujitjes apo mbjelljen e bimëve shumëvjeçare duhet të dëshmojë se ai/ajo është pronar i tokës/ndërtesës ku do të bëhet investimi që ka të drejtë të përdorë/marrë me qira atë për të paktën 10 vite. Kontratat e nënshkruar dhe e noterizuar për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit;

3.4 Tokat pyjore sipas certifikatës së pronësisë nuk pranohen si tokë bujqësore;

3.5 Tokat e privatizuara nga AKP-ja, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si "tokë e marrë me qira për 99 vite" trajtohen si tokë në pronësi të privatizuesit;

3.6 Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të noterizuara apo të vërtetuara nga gjykata, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK), Agjencionin e Kosovës për Privatizim (AKP) apo me Komuna, të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara;

3.7 Aplikuesi duhet të ketë të rregulluara detyrime ndaj shtetit, detyrime fiskale, tatimet në pronë ose në të ardhura ose ndonjë obligim tjetër ndaj shtetit.

## 4. Obligimet e përfituesit

4.1 Investimi për të cilin përfituesi ka marrë mbështetje nuk duhet të pësojë ndryshim thelbësor brenda pesë (5) viteve nga data kur pagesa përfundimtare është pranuar. Ndryshime thelbësore të një investimi janë ato që rezultojnë në:

4.1.1. Ndërprerjen ose zhvendosjen e aktivitetit prodhues në një fushë që nuk është e mbuluar me projektin në të cilin ka përfituar;

4.1.2. Ndryshime në strukturën e pronësisë më shumë se 50 %;

4.1.3. Ndryshime përmbajtjësore që ndikojnë në natyrën, objektivat ose kushtet e implementimit të cilat rezultojnë me ndryshimin e objektivave fillestare;

4.2. Ndryshime thelbësore lejohen në rastet në vijim:

4.2.1. Ndryshime në strukturën e pronësisë në rast të vdekjes së pronarit/përfituesit;

4.2.2. Në rast të situatave të jashtëzakonshme që mund të ndikojnë në investim nga fatkeqësitë natyrore. Në këto raste përfituesi duhet të informojë AZHB-në brenda afateve, sipas kontratës së nënshkruar nga të dy palët;

4.2.3. Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendura, AZHB-ja duhet menjëherë të informojë palën për shkelje të kontratës dhe Zyra ligjore e AZHB-së duhet të fillojë procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi;

**5. Investimet e pranueshme për mbështetje**

5.1 Ndërtimi/zgjerimi/ rinovimi i pronës së paluajtshme (përveç masave që nuk parashihet ndërtim);

5.2. Blerja e makinerisë dhe pajisjeve të reja, përfshirë softuerin kompjuterik;

5.3. Blerja e fidanëve të bimëve shumëvjeçare;

5.4. Blerja e mëshqerrave të mbarësuara/lopë qumështore të racës të matrikuluara dhe me pedigre;

5.5. Si shpenzim i pranueshëm për masat 1 dhe 3, është edhe angazhimi i studentit ose të posa diplomuarit, (deri një vit pas diplomimit). Vlera e mbështetjes nga MBPZHR-ja do të jetë 2100 € për punë praktike gjashtëmujore, e dëshmuar përmes kontratës së noterizuar;

5.6. Asnjë lloj investimi nuk pranohet të ri financohet pa kaluar periudha e amortizimit të plotë të atij investimi sipas listës së ATK-së (legjislacionit të aplikuar nga ATK): Pajisje, makineri, ndërtesa );

5.7. AZHB-ja duhet të mbajë një listë të investimeve për secilin fermer dhe gjatë aplikimeve në vitet e ardhshme ajo duhet t'i nënshtrohet kontrollit krahasues nga vitet paraprake për investim të njëjtë për përfituesin e njëjtë;

5.8. Vetëm shpenzimet e bëra pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet përfituesit dhe AZHB-së konsiderohen të pranueshme për bashkëfinancim;

5.9. Përfituesi duhet të sigurojë dokumentacionin e detajuar që arsyeton vërtetësinë dhe vlefshmërinë e shpenzimeve me kërkesën për pagesat e prezantuara në AZHB;

5.10. AZHB-ja është përgjegjëse për të kontrolluar vërtetësinë dhe vlefshmërinë e shpenzimeve;

5.11. AZHB-ja publikon kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e nevojshme për arsyetimin e shpenzimeve nga aplikuesi/përfituesi në udhëzuesit për aplikues;

5.12. Një listë e shpenzimeve të pranueshme, e specifikuar, do të ju ofrohet fermerëve si aneks në udhëzuesin për aplikues.

**6. Verifikimi i shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare:**

6.1 Aplikacionet e kompletuara i nënshtrohen vlerësimit të mëtutjeshëm të shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare;

6.2 Pranueshmëria e shpenzimeve kontrollohet duke krahasuar me çmimet referente të aprovuara nga AZHB-ja ose me ofertat nga tregu;

6.3 Vlera e shpenzimeve të pranueshme verifikohet më tutje nëse korrespondon me vlerën e tregut të artikujve përkatës të dëshmuara përmes tri ofertave të ndryshme nga furnizuesit (për mallrat me vlerë mbi 10,000 €), duke krahasuar me vlerat referente të përcaktuara nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

6.4 Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme te projektit vlerësohet duke krahasuar pragun minimal dhe maksimal të përcaktuar me projekt;

6.5 Nëse shuma e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme është nën minimum, projekti refuzohet;

6.6 Nëse vlera e projektit është mbi pragun, projekti mbetet i pranueshëm, ndërsa e gjithë vlera që shkon përtej pragut duhet të mbështetet plotësisht nga përfituesi;

6.7 Vlerësimet e qëndrueshmërisë ekonomike – financiare bëhen për projektet që përmbushin kërkesat e pranueshmerisë dhe që kanë dokumentacionin e kompletuar;

6.8 Vlerësimi kryhet sipas metodologjisë së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për kriteret e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare.

**7. Kriteret e përzgjedhjes/Poentimi**

7.1.Vlerësimi i projekteve bëhet në bazë të kritereve të përzgjedhjes, sipas masave dhe nënmasave;

7.2.Një projekt/aplikacion mund të përzgjidhet për mbështetje vetëm nëse arrin pragun minimal 50 pikë. Pragu minimal vendoset për të siguruar që projektet e përkrahura sjellin vlerë të shtuar të mjaftueshme për sektorin;

7.3.Pragu minimal i pranueshëm duhet të jetë jo me pak se 50 pikë;

7.4.Në rast kur kemi pikë të njëjta, përparësi ka aplikuesi i cili ka aplikuar më herët.

## KAPITULLI II
## MASA 1
## INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE

### Neni 7
### Përfituesit

**1. Përfituesit:**

1.1 Përfituesit nën këtë masë janë fermerët, sipas përkufizimit në Ligjin Nr.08/L-072 për

Bujqësi dhe Zhvillim Rural;

1.2 Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës. Certifikata e fermerit (NIF) duhet të jetë në emër të aplikuesit;

1.3 Nëse aplikuesi është ndërmarrje, edhe certifikata e NIF-it duhet të jetë në emër të ndërmarrjes;

## 2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë.

2.1 Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, por që nuk i ka mbushur 65 vjet. Në rastin e ndërmarrjeve ky kriter nuk aplikohet;

2.2 Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar së paku shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar);

2.3 Aplikuesi duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon, kurse ata që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit. Ky kriter nuk vlen për të diplomuarit në bujqësi qoftë në shkollën e mesme apo në fakultet*;*

2.4 Në rastin e ndërmarrjeve, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin, për të punësuarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes;

2.5 I punësuari i ndërmarrjes ose personi i autorizuar duhet të ketë kontratë pune së paku edhe për pesë (5) vite pas momentit të aplikimit;

2.6 Aplikuesit duhet t'i kenë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë:

2.6.1 Personat fizik, tatimin në pronë, kurse

2.7.2 Ndërmarrjet, tatimin në të ardhura të korporatave;

2.7. Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve me kopje të letërnjoftimeve; Në pëlqim duhet të specifikohet nëse pëlqimi vlen vetëm për hisen e aplikuesit apo edhe për hisen e bashkëpronarit;

2.8. Në rast se toka në certifikatën e pronësisë është mal ose tokë pyjore, ose kategori tjetër dhe në terren është tokë bujqësore, aplikuesi nese planifikon të shfrytzoj atë si tokë bujqësore duhet paraprakisht t'a ndërrojë destinimin e tokës në kadastër dhe pastaj të aplikojë;

2.9 Në rastet e tokave të marra me qira nga APK apo AKP, pranohen edhe tokat pyjore me kusht që në aplikacion të bashkëngjitet një vërtetim nga APK apo AKP se toka në fjalë është tokë bujqësore;

2.10 Personat fizik përfitues të projekteve me vlerë të investimeve të pranueshme më të madhe se 30,000 €, ose përfituesit të cilët në planin e biznesit kanë deklaruar punëtor të rinj

dhe për të cilët janë poentuar, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet si person juridik apo biznes individual, ndërsa investimet/shpenzimet e zbatimit të projektit duhet të faturohen në emër të biznesit;

2.11 Përfituesit të cilët në planin e biznesit janë zotuar të kenë të punësuar, duhet të regjistrohen në ARBK së paku si biznes individual dhe të gjitha pagesat duhet të bëhen nga llogaria e biznesit;

2.12 Të gjithë aplikuesit të cilët kanë biznes të regjistruar aktiv në ARBK me aktivitete ne sektorin e bujqësisë duhet të aplikojnë si biznes - Përjashtim bëjnë aplikuesit të cilët janë bashkëpronar në biznes;

2.13 Të gjithë përfituesit e projekteve në vlerë më të madhe se 50.000 euro janë të obliguar të pranojnë një student/të sapodiplomuar për kryerjen e praktikës profesionale në kohëzgjatje prej 6 muajsh, nëse ka të interesuar për këtë. Prandaj, këta aplikues e parashohin në planin e tyre të biznesit edhe angazhimin e studentit/sapodiplomuarit;

2.14 Në rast të angazhimit të studentit, kjo bëhet me kontratë pune praktike të noterizuar në vlerë prej 2100 euro bruto për 6 muaj dhe do të financohet 100% nga përkrahja publike (Procedurat e pagesës do të përshkruhen në udhëzuesin për fermer);

2.15 Studentët dhe të posa diplomuarit, deri një vit pas diplomimit, të drejtimit të bujqësisë ose veterinarisë duhet të jetë me përgatitje profesionale të njëjtë ose të përafërt me sektorin për të cilin aplikon. Kjo vlen edhe për angazhimin e studenteve të nivelit master por nuk vlen për studentet qe kanë qenë te angazhuar në vitet paraprake në projekte;

2.16 Të gjithë aplikuesit të cilët aplikojnë në vlerë mbi 30,000 – 50,000 euro të investimeve të pranueshme, janë të obliguar që në plan të biznesit të paraqesin angazhimin e nxënëseve të shkollave profesionale bujqësore në periudhë prej 6 muajsh. Angazhimi i nxënësve është opsional, nëse ka të interesuar. MBPZHR bënë njoftim publik për nxënësit/studentet/të posadiplomuarit të cilët janë të interesuar për kryerjen e praktikes profesionale;

2.17 Angazhimi i nxënësve do të jetë në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 02/2024 për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve;

2.18 Pas përfundimit të mësimit/punës praktike (në afat prej gjashtëmuajsh) të studenteve/të posa diplomuarve dhe nxënësve, fermeri/përfituesi obligohet t’i lëshoj dëshmi për kryerjen e mësimit/punës praktike;

2.19 Në rast të sëmundjeve të cilat dëmtojnë numër të madh të kafshëve/shpezëve, duhet të sigurohet vërtetimi i AUV, nëse ka ngordhje masive nga shkaktarët tjerë duhet të dokumentohet shkaku i ngordhjes nga institucioni përgjegjës, dhe për këtë të njoftohet AZHB;

2.20 Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t’i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë 5 viteve pas ekzekutimit të pagesës së fundit nga AZHB. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet t’a kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;

2.21 Aplikuesi mund të zgjidhet përfitues potencial por nuk mund të nënshkruaj kontratë të re me AZHB-në, nëse nuk e ka përfunduar dhe mirëmbajtur investimin paraprak:

**3. Qëndrueshmëria ekonomike**

3.1 Aplikuesi duhet të dëshmojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës përmes planit të biznesit, bazuar në rezultatet që synon të arrijë, përmes tregueseve të matshme, të paraqitur në projekt; Investimet e planifikuara duhet të jenë në përputhje me kapacitetin prodhues. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, duke u bazuar në planin e biznesit, zyrtarët e AZHB-së janë të obliguar të refuzojnë pjesën e investimeve të cilat janë në kundërshtim me këtë parim.

3.2 Në rastet ku vlera e projektit të aplikuesit është mbi 50.000 euro atëherë aplikuesi duhet te sjellë dëshmi mbi gjendjen e tij financiare:

3.2.1 Subjekti i regjistruar juridik duhet si dëshmi të ofroj pasqyrat e të ardhurave të agrobiznesit për vitin paraprak të cilat i ka dorëzuar në ATK;

3.2.2 Personi fizik duhet të dëshmoj qarkullimin bankar përmes gjendjes së llogarisë bankare për 12 muajtë e fundit para datës se aplikimit.

3.3 Aplikuesi, personi fizik dhe ai juridik, duhet të dëshmoj se ka pasur qarkullim financiar për së paku 50% të vlerës së bashkëfinancimit nga ana e aplikuesit/përfituesit.

**4. Standardet kombëtare/BE**

4.1. Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit janë paraqitur në udhëzuesin për aplikues;

4.2. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe verifikohen me rastin e kontrollit të personit zyrtar në vendin e investimit;

4.3. Në rast të investimeve në pemishte dhe vreshta të reja, para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim, përfituesi i grantit duhet të sjellë analizat kimike dhe fizike të tokës me rekomandim pozitiv për përshtatshmërinë për investimin e paraparë. Në rast se rekomandimi është negativ refuzohet dhënia e grantit.

**5. Kriteret tjera të pranueshmërisë**

5.1. Përfituesit e projekteve me vlerë të investimeve të pranueshme më të madhe se 30,000 €, ose përfituesit të cilët në planin e biznesit kanë deklaruar punëtor të rinj dhe për të cilët janë poentuar, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet si person juridik apo biznes individual dhe investimet/shpenzimet e zbatimit të projektit duhet të faturohen në emër të biznesit;

5.2. Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2024 nuk lejohet të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të

detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me ligjin;

5.3. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në (5) pesë vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, zyrtarët vlerësues të projektit e shtypin letër-informimin për miratimin e atij projekti dhe me rastin e kontrollit të parë në terren, inspektorët së pari e kontrollojnë projektin e viteve paraprake. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe/ose nuk është funksional, nuk mund të lidhet kontrata e re;

5.4. Të gjitha asetet që kanë të bëjnë me investimin dhe për të cilat ka rubrika përkatëse në aneksin e NIF-it duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermës;

5.5. Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të noterizuara apo të vërtetuara nga gjykata, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK), Agjencioni i Kosovës për Privatizim (AKP) dhe me Komuna të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara;

5.6. Tokat e privatizuara nga AKP-ja, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si “tokë e marrë me qira për 99 vjet” trajtohen si tokë në pronësi të privatizuesit. Edhe tokat e blera nga privatizuesit trajtohen si tokë në pronësi të blerësit;

5.7. Tokat me komasacion të papërfunduar pranohen me vendime të organit kompetent, pra edhe pa certifikatë të pronës;

5.8. Vendi/toka/objekti nën hipotekë ku realizohet investimi, nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira ndërsa toka si dëshmi për investime në makineri, pajisje apo si bazë ushqimore për kafshë është e pranueshme edhe nëse është nën hipotekë;

5.9. Të bëhet digjitalizimi i parcelës ku bëhet investimi;

5.10. Në rast se ngastrat janë ngjitur fizikisht me njëra-tjetrën pranohen si një ngastër, qoftë edhe në rastet kur njëra është me qira dhe tjetra në pronësi;

5.11. Të gjithë përfituesit të cilët në planin e biznesit të tyre kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës obligohen t’i krijojnë ato dhe ta dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në pagë, duke filluar të paktën nga muaji i fundit para dorëzimit të kërkesës për pagesën e fundit;

5.12. Përfituesit janë të obliguar të mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për aq sa zgjatë periudha monitoruese;

5.13. Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në bashkëpronësi, në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufi (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat në bazë të ligjit në fuqi), dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, apo certifikatës së lindjes apo certifikatës së vdekjes. Poashtu aplikuesi duhet te derzoj deklaratën nen betim me te cilën dëshmon se ai eshte trashëgimtar potencial i tokës me te cilën ka aplikuar per investim.

5.14. Kalkulimi i vendeve te reja te punës do te behet duke u bazuar ne tabelën e cila është e paraqitur ne udhëzues për aplikues por jo me shume se qe ka deklaruar ne biznes plan dhe për këtë kanë përfituar pikë gjatë vlerësimit.

5.13. Të gjithë aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

5.12.1 Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi (në rastet kur toka/objekti është marrë me qira, fleta poseduese e tokës ku është toka/objekti duhet të jetë në emër të qiradhënësit);

5.12.2 Në rast se toka/objekti është marrë me qira, kërkohet kontrata e noterizuar e qirasë për së paku 10 vite. Nëse kontrata është nënshkruar dhe noterizuar para datës së aplikimit, duhet të mbulojë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit;

5.12.3 Kontrata e noterizuar duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit) për investimin që do të bëhet në tokën/objektin e tij;

5.12.4 Nëse toka/objekti në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve; Në pëlqim duhet të specifikohet nëse pëlqimi vlen vetëm për hisen e aplikuesit apo edhe për hisen e bashkëpronarit.

5.12.5 Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;

5.12.6 Aplikuesi duhet të plotësojë deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se ai është trashëgimtar potencial i tokës;

**5.13. Përveç këtyre dokumenteve, në rast të ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit të objekteve nevojiten edhe këto dokumente shtesë:**

5.13.1 Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara, dokument i përgatitur i veçantë (jo pjesë e planit të biznesit) nga vetë aplikuesi ose me ndihmën e ndërtuesit;

5.13.2 Dëshmi nga komuna që vërteton se në vendin e planifikuar për ndërtim ose zgjerim nuk është i ndaluar investimi i planifikuar;

5.13.3 Kopjen e skicave të objektit të cilat nuk kërkohen në rastin e investimeve në rinovimin e objekteve dhe për pajisje;

5.13.4 Përfituesi, me rastin e parashtrimit të kërkesës për pagesë në AZHB, njëkohësisht duhet të dorëzojë edhe lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës në rast të ndërtimit apo zgjerimit; Leja e ndërtimit kërkohet në të gjitha rastet e ndërtimeve/zgjerimeve me sipërfaqe mbi 10m²; nuk kërkohet për projektet e rinovimit.

**6. Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritëshme**

6.1. Në kuadër të këtij investimi mbështetet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme për "vetë-konsum" (energjia elektrike e prodhuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartë me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet, rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm;

6.2. Vetë-konsumi duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet/vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së rinovueshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vitesh të ekonomisë familjare.

6.3. Në rastin e fermave të reja ose në rastet e fermave që kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore madhësinë e veprimtarisë së tyre në tre vitet e fundit, konsumi i pritshëm duhet të vlerësohet nga AZHB-ja.

## 7. Shpenzimet e përbashkëta të pranueshme

7.1 Si shpenzim i pranueshëm për këtë masë do të jetë angazhimi i një studenti/posa diplomuari, përfshirë nivelin master;

7.2 Vlera e pagesës do të jetë 2,100 €, 100% përkrahje publike për periudhën gjashtëmujore, kjo dëshmohet përmes kontratës për punë praktike të noterizuar;

7.3 Realizmi i pagesës do të bëhet sipas proceduarave të paraqitura në udhëzuesin për aplikues**;**

7.4 Të gjitha shpenzimet tjera të pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 1.

## 8. Investimet tjera

8.1. Blerja e makinave dhe pajisjeve të reja, përfshirë softuerin kompjuterik me çmime të tregut. Arsyeshmëria e investimeve në makineri, në pajisjet e TI-së si dhe softuerët duhet të arsyetohen mirë në planin e biznesit;

8.2. Investimet për blerje të traktorit do të pranohen vetëm në ato raste kur ekziston një korrelacion i ngushtë ndërmjet madhësisë/fuqisë së traktorit dhe ngarkesës së punës/madhësisë së fermës/kapacitetit ;

8.3. Një listë e detajuar e shpenzimeve të pranueshme në kuadër të kësaj mase do të paraqitet në listën e shpenzimeve të pranueshme për masën 1 në udhëzuesin për aplikues.

## 9. Shkalla e përkrahjes publike

9.1 Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç për pemë manore dhe rrush për të cilat vlera minimale është 5,000 €;

9.2 Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 100,000 euro;

9.3 Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme e lejuar për njësi, sipas nënmasave:

9.3.1 Jo më shumë se: 35,000 euro, për ngritjen e 1 ha pemë drufrutore;

9.3.2 Jo më shumë se: 30,000 euro, për ngritjen 1 ha pemë arrore;

9.3.3 Jo më shumë se: 25,000 euro, për ngritjen 1 ha pemë manore;

9.3.4 Jo më shumë se: 35,000 euro, për ngritjen 1 ha boronica;

9.3.5 Jo më shumë se: 25,000 euro, për ngritjen 0.1 ha serra;

9.3.6 Jo më shumë se: 30,000 euro, për ngritjen 1 ha rrush;

9.3.7 Jo më shumë se: 10,000 euro, për nënmasën për depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve për një ha me pemë dhe/ose perime;

9.3.8 Jo më shumë se: 2,000 euro për 1 ha drithëra;

9.3.9 Jo më shumë se: 2,500 euro për 1 krerë lope qumështore**;**

9.3.10 Jo me shumë se: 2,000 euro për 1 krerë viça;

9.3.11 Jo me shumë se: 1,000 euro për 1 krerë derri;

9.3.12 Jo me shumë se: 300 euro për 1 krerë dele/dhi;

9.3.13 Jo me shumë se: 10 euro për 1 pulë.

9.4 Në rast të investimeve në pemishte, vreshta dhe serra ekzistuese, shuma maksimale e lejuar e investimit për njësi (ha) është sa gjysma e shumës së lejuar për ngritje të sipërfaqes së re me përjashtim ne rast te investimeve ne sistemin kundër bresherit ku shuma e lejuar është 25 mije euro;

9.5 Në rast të investimeve në stallat ekzistuese, shuma maksimale e lejuar e investimit për njësi, është sa gjysma e shumës së lejuar për ngritje e stallave.

9.6 Investimet në pemishte/pemët-serrat/vreshtat/stallat ekzistuese, nuk pranohen investimet e njejta të cilat janë mbështetur përmes PZHR, për periudhën aq sa zgjat periudha e monitorimit;

9.7 Mbështetja publike për projekt është 60%;

9.8 +5% për investime në zona malore ;
+5% për investime në asete fizike të ekonomive bujqësore në pronësi të fermerëve të ri;

9.9 Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të PKBZHR (2023 – 2027) për Masën 1 është 240,000 € për përfitues;

9.10 Pagesa për angazhim të studentit/të posadiplomuarit (për përfituesit me mbi 50,000 euro të investime të pranueshme*)* do të mbështetet 100% nga përkrahja publike. (Procedurat e pagesës do të përshkruhen në udhëzuesin për fermer);

9.11 Pagesa për Masën 1 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;

9.12 Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;

9.13 Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave;

9.14 Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.

**10. Afati i zbatimit**

10.1. Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë kalendarike, përveç për projekte që parashohin ndërtim të stallës apo të depos me ç'rast afati i zbatimit është 150 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në dhe për sektorin e rrushit, për projektet e të cilit afati i zbatimit është 300 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, për shkak të periudhës pranverore të mbjelljes së rrushit.

10.2. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit deri në 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtet e papërshtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër. Periudha e fillimit te implementimit përcaktohet me kontratë.

10.3. Pas afatit të zbatimit, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

## KAPITULLI III
## NËNMASAT
## I. SEKTORI I PEMËVE

### Neni 8
### Kriteret e pranueshmërisë

**1.** Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e pemëve - **molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, gështenja, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedra, manaferra, boronica dhe aronia.**

1.1 Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira, së paku 1 hektar për pemë drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, gështenja, qershia, kajsia, pjeshka dhe ftoni) dhe/ose 0.25 hektar për pemë manore (dredhëza, mjedra, boronica, manaferra dhe aronia). Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë manore duhet të jetë 0.10 hektar dhe për pemë drufrutore 0.35 hektar;

1.2 Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidan të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese;

1.3 Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues;

1.4 Investimet për depo për ruajtje dhe trajtim pas vjeljes si dhe për mekanizim dhe pajisje, përfshirë blerjen e traktorit për pemë, lejohen vetëm për aplikuesit me sipërfaqet me pemishte ekzistuese prej 3 (tre) e më shumë ha në momentin e aplikimit të cilat duhet të dëshmohen me marrjen e pagesave direkte për se paku dy vite brenda 3 viteve të fundit;

**2. Investimet e pranueshme në sektorin e pemëve:**

2.1 Investimet në ngritjen/modernizim e pemishteve;

2.2 Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;

2.3 Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtritshme;

2.4 Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshri dhe ngricat;

2.5 Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;

2.6 Investimet për blerje të traktorit për pemët drufrutore (për aplikuesit me 3 e më shumë ha me pemë në fushe të hapur dhe patate);

2.7 Investimet për blerje të motokultivatorit për pemë manore;

2.8 Investime në ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo, makineri dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe produkteve për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale në përputhje me kapacitetin prodhues.

**3 Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 - Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e pemëve janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

## II. SEKTORI I PERIMEVE DHE SERRAVE PËRFSHIRË PATATET

### Neni 9
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e pranueshmërisë për sektorin e perimeve, serrave, serrat për fidane përfshirë patatet:**
**Sektori i perimeve (përfshirë patatet)**

1.1 Nënmasa 1.4 e perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për fidane;

Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmojë se ka së paku 0.12 hektar tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira. Madhësia minimale e një serre të pandarë është 0,10 ha;

Serra për fidan duhet të bëhet në bazë të parametrave optimale të paraqitura në udhëzuesin për aplikues.

1.2 Nënmasa 1.5 – depo për ruajtje të pemëve dhe perimeve

Në momentin e aplikimit për investime në depo për perime (përfshirë pataten) dhe mekanizim dhe pajisje, përfshirë traktorin, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektar sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira. Këta aplikues duhet të dëshmojnë që janë përfitues të subvencioneve për së paku dy vite brenda 3 viteve të fundit, përmes vendimit për marrje të subvencioneve.

**2. Investimet e pranueshme në sektorin e perimeve në fushë të hapur përfshirë pataten, serra, serra për fidan dhe depo:**

2.1 Investimet në ndërtimin/modernizim e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidane;

2.2 Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;

2.3 Investime në blerjen dhe instalimin e pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;

2.4 Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;

2.5 Investime për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim dhe makineri speciale për vjelje të patates;

2.6 Investime ne ndërtimin e objekteve për vendosjen e makinave, si dhe produkteve për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale (për aplikuesit me 3 e më shumë ha me perime në fushe të hapur dhe patate);

2.7 Investime për blerjen e traktorit me pajisje përcjellëse (për aplikuesit me 3 e më shumë ha me perime në fushe të hapur dhe patate);

2.8 Investime ne moto kultivatorë dhe pajisje përcjellëse për serra;

2.9 Investime në blerjen e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra, makinë për mbjelljen e fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.

**3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e perimeve serrave dhe serrave per fidane - përfshirë patatet janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ**

## III. SEKTORI I MISHIT

### Neni 10
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e mishit:**

1.1 Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave ), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, të regjistruar në Regjistrin e Identifikimit të Kafshëve dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë. Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare);

1.2 Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se kanë së paku 0,20 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, (sipërfaqja e tokës duhet të jetë në relacion me numrin e krerëve në fund të investimit të paraqitura në planin e biznesit) në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 5 vite.

**2. Investimet e pranueshme:**

2.1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi/ i stallave, objekteve përcjellëse-deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit dhe infrastrukturës në fermë si furnizim me ujë në nivel ferme;

2.2. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtritshme;

2.3.Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;

2.4.Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;

2.5.Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik, të lëngët dhe të ngurtë, dhe deponimin e tij;

2.6.Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

**3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e mishit janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

## IV. SEKTORI I QUMËSHTIT

### Neni 11
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:**

**1.1 Nënmasa për prodhimin e qumështit nga lopët qumështore**

1.1.1 Për investime në sektorin e qumështit nga lopët, aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë lopë/mështjerra në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 10 krerë lopë me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, të regjistruar në Regjistrin e Identifikimit të Kafshëve, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë;

1.1.2 Mosha e mëshqerrave barrëse/lopëve qumështore që i posedon fermeri, nuk duhet të jetë më e re se 18 muaj dhe jo më e vjetër se 12 vite;

1.1.3 Mosha e mëshqerrave barrëse/lopëve qumështore të blerë përmes projektit, nuk duhet të jetë më e re se 18 muaj dhe jo më e vjetër se 36 muaj;

1.1.4 Fermerët të cilët aplikojnë për rritjen e fondit blegtoral (mëshqerrave barrëse/lopëve qumështore) duhet të kenë të ndërtuar stallën sipas kritereve zooteknike të përcaktuara në udhëzuesin për aplikues dhe të kenë kapacitete të mjaftueshme për mbarështimin e krerëve të përfituar, kjo dëshmohet përmes fotove, tabelës së aseteve në projekt dhe gjendjes faktike të konstatuar nga inspektori në terren.

**1.2 Nënmasa për prodhimin e qumështit nga delet dhe dhitë**

1.2.1 Aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit nga bagëtia e imët duhet të kenë së paku 130 dele ose 130 dhi, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve (RRIK) në AUV;

1.2.2 Aplikuesit nga sektori i deleve/dhive kanë të drejtë të aplikojnë për ndërtimin e stallës por nuk janë të obliguar të ndërtojnë depo të plehut;

1.2.3 Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë deleje/dhie, (sipërfaqet e tokës duhet të jenë në relacion me numrin e krerëve në fund të investimit, të

paraqitura në planin e biznesit) në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku pesë (5) vite.

**1.3 Nënmasa për pikat grumbulluese të qumështit**

1.3.1 Pikat grumbulluese të qumështit duhet të kenë kontrata afatgjata, aq sa zgjatë periudha monitoruese ose më shumë. Së paku 5 fermerë të cilët bashkërisht mbarështojnë së paku 30 lopë qumështore;

**2. Investimet e pranueshme:**

**2.1 <u>Lopë qumështore:</u>**

2.1.1 Investime në blerjen e mëshqerrave barrëse/lopëve qumështore të matrikuluara dhe me pedigre të racave si në vijim:

2.1.1.1 Holstein - zi e bardhë dhe kuq e bardhë. Kjo racë nuk mbështetet për zona malore me lartësi mbidetare mbi 700 m;

2.1.1.2 Simental;

2.1.1.3 Montbeliarde;

2.1.1.4 Brown Swiss;

2.1.1.5 Tarentaise

2.2 Numri lopëve/mështjerrave që mund të blej përfituesi i projektit është si në vijim:

2.2.1 Aplikuesit që në momentin e aplikimit kanë 0 deri në 5 lopë\mështjerra duhet që të sigurojnë 5 lopë/mështjerra me vetë investim, dhe t'i blejnë edhe 5 të tjera me përkrahje publike ashtu që në fund të investimit t'i kenë së paku 10 lopë/mështjerra, sipas kritereve të përcaktuara.

2.2.2. Ata që në momentin e aplikimit kanë më shumë se pesë lopë/mështjerra, mund t'i blejnë me përkrahje publike edhe deri në aq krerë sa i posedojnë, por jo më pak se 5 krerë dhe jo me shumë se 25 krerë. Numri i krerëve ekzistues duhet të dëshmohet me listën e kafshëve nga AUV dhe praninë e tyre në stallë me rastin e kontrollit të parë në terren.

**2.2 <u>Dele dhe dhi:</u>**

2.2.1 Aplikuesit nga sektori i deleve/dhive kanë të drejtë të aplikojnë për ndërtimin/ zgjerim dhe rinovim të stallës por nuk janë të obliguar të ndërtojnë depo të plehut;

2.2.2 Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje, si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit, përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;

2.2.3 Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;

2.2.4 Pajisjet dhe makineritë për heqjen e plehut organik, pastrimin e dyshemesë, për shmangien e rrjedhjes së urinës (plehut të lëngët), për lehtësimin e transportit të plehut organik të ngurtë dhe të lëngët drejt objektit të magazinimit/deponimit;

2.2.5 Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;

2.2.6 Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;

2.2.7 Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

**2.3 Pikat grumbulluese të qumështit**

2.3.1 Investime në ndërtim, zgjerim apo rinovim të objektit të pikës grumbulluese;

2.3.2 Investime në pajisje dhe laktofrizë.

**3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e qumështit janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

## V. SEKTORI I RRUSHIT

### Neni 12
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:**

1.1 Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira dhe atë së paku 0.50 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.10 hektar;

1.2 Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet t'a mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit dhe të jenë të regjistruara në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës;

1.3 Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektar me vreshta, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vite;

1.4 Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës se aplikimit, duhet t'a mbulojnë periudhën kohore për se paku 5 vite nga dita e aprovimit dhe të jenë të regjistruara në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

**2. Investimet e pranueshme:**

2.1 Investimet në ngritjen/modernizim të vreshtave me rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.50 ha;

2.2 Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes sipas praktikave efikase të ujitjes;

2.3 Investimet në vendosjen e plasmanit për rrush të tryezës;

2.4 Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;

2.5 Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshri;

2.6 Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;

2.7 Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;

2.8 Aplikuesve që kanë tre (3) e më shumë hektar sipërfaqe me vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim.

2.9 Ata që kanë mbi 3 hektar sipërfaqe me vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim.

**3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e rrushit janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

## VI. SEKTORI I VEZËVE

### Neni 13
### Kriteret e pranueshmerisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:**

1.1. Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive;

1.2. Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare);

1.3. Aplikuesit në sektorin e vezëve, me rastin e aplikimit duhet të shënojnë në planin e biznesit kur do të bëjnë ndërrimin e turnusit dhe sa do të zgjasë pauza pa prodhim;

1.4. Aplikuesi duhet të dorëzoj edhe faturën e furnizimit të fundit me pula. Në rast të sëmundjeve të cilat dëmtojnë numër të madh të pulave, duhet të sigurohet vërtetimi i AUV;

1.5. Nëse ka ngordhje masive të pulave nga shkaktarët tjerë duhet të dokumentohet shkaku i ngordhjes nga institucioni përgjegjës.

**2. Investimet e pranueshme janë**:

2.1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;

2.2. Investimet në infrastrukturë të brendshme, sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve;

2.3. Investimet në kafaze vetëm sipas standardeve të BE-së;

2.4 Ndërtimi dhe rinovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;

2.5 Investimet në pajisje për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtritshme;

2.6 Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij;

2.7 Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

3. **Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e vezëve janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 2 të këtij Udhëzimi Administrativ**.

## VII. SEKTORI I DRITHËRAVE- GRURË DHE MISËR

### Neni 14
### Kriteret e pranueshmerisë

1. **Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:**

1.1 Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e drithërave aplikuesi duhet të ketë së paku 5 hektar tokë në pronësi apo si trashëgimtar potencial;

1.2 Të dëshmojë se ka së paku 30 hektar tokë të punueshme në pronësi, të trashëguar potencial apo të marrë me qira dhe ta dëshmoj me vendimin për marrje të pagesave direkte për se paku dy vite brenda tri viteve të fundit me grurë dhe misër;

1.3 Përfituesit duhet të mbjellin së paku aq sipërfaqe me drithëra sa kanë mbjellë në vitin kur kanë fituar projektin edhe gjatë 5 viteve të periudhës monitoruese.

2.**Investimet e pranueshme janë**:

2.1 Investimet në makineri bujqësore, përfshirë autokombajnën, traktorin dhe pajisje për kultivim të tokës si lëvrim, frezim, pijatim, trinim, pajisje për mbjellje, mbrojtje të bimëve dhe plehërim;

**3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin; sektori i drithërave- janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ**.

# KAPITULLI IV
# MASA 3
# INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE

## Neni 15
## Përfituesit

**1. Përfituesit përfundimtar:**

1.1 Përfitues mund të jenë ndërmarrjet përpunuese të prodhimeve bujqësore të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës në nënsektorin përkatës dhe të aprovuara/regjistruara nga AUV-i para datës së aplikimit;

1.2 Aplikuesit në sektorin e verës, duhet të jenë të regjistruar edhe në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë;

1.3 Agro bizneset fillestare deri në dy vite përvoje mund të aplikojnë deri në 200.000 euro investime të pranueshme, ndërsa bizneset me përvoje 2 e me shumë vite mund të aplikojnë deri në 400,000 euro**.**

**2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë**

**2.1. Llojet e ndërmarrjeve të përkrahura:**

2.1.1. Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe në ARBK;

2.1.2. Kjo masë përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të përcaktuara në bazë të Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

**2.2. Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes:**

2.2.1 Qëndrueshmëria ekonomike e aplikuesit duhet të demonstrohet me anë të një plani biznesi.

2.2.2 Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes.

2.2.3 Plani i biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara, konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve. Gjithashtu, plani i biznesit duhet të tregojë se në çfarë mënyre zbatimi i projektit do të çojë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të ndërmarrjes agro-ushqimore përmes prezantimit të perspektivës së qëndrueshmërisë financiare/ekonomike.

2.2.4 Vlerësimi i qëndrueshmërisë financiare/ekonomike dhe perspektiva e vazhdimësisë së investimeve vlerësohet nga AZHB-ja, për të siguruar zgjedhjen e projekteve me cilësi më të

lartë për sa i përket qëndrueshmërisë financiare/ekonomike. Modeli për planin e biznesit përgatitet nga AZHB-ja dhe publikohet në web-faqen e Agjencisë dhe MBPZHR-së.

### 2.3. Standardet Kombëtare / Standardet e BE-së:

2.3.1 Ndërmarrja duhet të demonstrojë qartë planin e investimeve në planin e biznesit, të cilat do të ndikojnë në zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe uljen e rrezikshmërisë sipas kategorizimeve. Para paraqitjes së kërkesës për pagesë në AZHB, secili projekt duhet të vlerësohet nga AUV-i nëse janë plotësuar standardet minimale kryesore kombëtare sipas ligjeve në fuqi.

2.3.2 Përfituesit së bashku me kërkesën për pagesë dhe dokumente tjera, duhet të sigurojnë Raportin të bashkëngjitur me Listat e Kontrollit nga AUV-i që konfirmon se investimi është në përputhje me standardet minimale kombëtare. E gjithë ndërmarrja përfituese në fund të zbatimit duhet të përmbushë standardet kombëtare sipas ligjeve në fuqi.

2.3.3 Aplikuesit duhet të kenë raportin/procesverbalin (jo me të vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga AUV-i për gjendjen ekzistuese të operatorit dhe cilat standarde duhet t'i plotësoj. Konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve në planin e biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara.

2.3.4 Para kërkesës përfundimtare për pagesë në AZHB, investimi i mbështetur duhet të plotësojë standardet kombëtare relevante në fuqi që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë.

### 2.4. Kriteret tjera të pranueshmërisë

2.4.1.Toka/objekti ku do të realizohen investimet gjegjësisht vendosen pajisjet e blera sipas projektit, janë të pranueshme për investim edhe nëse janë nën hipotekë (qoftë në pronësi apo të marrë me qira), përjashtimisht investimet për ndërtim/zgjerim të objekteve të kategorisë D dhe për pika grumbulluese/depo nuk është e pranueshëm ndërtimi i tyre në tokën nën hipotekë;

2.4.2.Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vite duke llogaritur nga viti i aplikimit. Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore për se paku 5 vite nga dita e aprovimit;

2.4.3.Në rastet e ndërtimeve/zgjerimeve me sipërfaqen e bazës mbi 10m², kërkohet leja e ndërtimit;

### 2.5 Të gjithë aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë

2.5.1 Certifikatën e pronësisë (fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; (Në raste kur toka/objekti është marrë me qira, fleta poseduese e tokës ku është toka/objekti duhet të jetë në emër të qiradhënësit);

2.5.2 Kontrata duhet të përmbajë dhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që

do të bëhet në tokën/objektin e tij;

2.5.3 Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve;

2.5.4 Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara, dokument i përgatitur i veçantë (jo pjesë e planit të biznesit) nuk vlen për investimet vetëm për pajisje por vlen për investime në rinovim dhe ndërtim;

2.5.5 Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;

2.5.6 Të gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose të rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në te ardhura dhe tatimet tjera të aplikueshme;

2.5.7 Aplikuesit janë të obliguar që në planin e biznesit të paraqesin se do të angazhojnë një student/e të posa diplomuar, për punë praktike në kohëzgjatje 6 muaj përmes kontratës së noterizuar, nëse ka të interesuar;

2.5.8 Studentet e angazhuar për punë praktike, duhet të jenë të vitit të fundit të studimeve apo të posa diplomuar, deri në një vit pas diplomimit, të fushave të bujqësisë dhe veterinarisë. Përjashtim bëjnë studentet /posadiplomuarit, që kanë qenë të angazhuar në projekte të PZHR-2023;

2.5.9 Vlera e pagesës do të jetë 2,100 € dhe do të financohet 100% nga përkrahja publike (Procedurat e pagesës do të përshkruhen në udhëzuesin për aplikues);

2.5.10 Nëse ka nxënës të shkollave të mesme profesionale bujqësore të interesuar për punë praktike, të gjithë përfituesit, janë të obliguar që të pranojnë angazhimin e tyre në periudhë prej 6 muajsh;

2.5.11 Angazhimi i nxënësve do të jetë në harmoni me U/A 02/2024 për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve. MBPZHR bënë njoftim publik për nxënësit/studentet/të posadiplomuarit të cilët janë të interesuar për kryerjen e praktikës profesionale;

2.5.12 Pas përfundimit të mësimit praktik, në afat prej gjashtë muajsh të nxënësit, përfituesi obligohet t'i lëshoj vërtetim për kryerjen e mësimit praktik të nxënësit;

**2.6 Përveç këtyre dokumenteve, në rast të ndërtimit, zgjerimit të objekteve nevojiten edhe këto dokumente shtesë:**

2.6.1 Projektin teknik ideor me paramasa;

2.6.2 Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;

2.6.3 Dëshmi nga komuna që vërteton se në vendin e planifikuar për ndërtim ose zgjerim nuk është i ndaluar investimi i planifikuar.

**2.7 Para kërkesës për pagesë, përfituesi duhet të dorëzojë:**

2.7.1 Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna), e cila nuk kërkohet për projektet e rinovimit;

**3. Investimet e përbashkëta të pranueshme**

**3.1. Investimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve për Masën 3:**

3.1.1 Ndërtimi/zgjerimi/rinovimi i objekteve. Ndërtimi është i pranueshëm vetëm për kategorinë “D”, kurse investimet në pajisje, janë të pranueshme për të gjitha kategoritë (“A”, “B”,“C” dhe “D”);

3.1.2 Blerja e makinerive dhe e pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;

3.1.3 Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat e Masës 3 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve etj, për promovimin e produkteve, por jo edhe për shpërndarjen e tyre. Poashtu, shpenzimet e pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spoteve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;

3.1.4 Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €;

3.1.5 Si shpenzim i pranueshëm për të gjitha nënmasat do të jetë edhe angazhimi i një studenti në vitin e fundit të studimeve apo të sapo diplomuar në fushën e teknologjisë ushqimore, blegtori, pemëtari, perimëtari dhe vreshtari. Kjo vlen edhe për angazhimin e studenteve të nivelit master. Vlera e pagesës për angazhim gjashtëmujor të studentit/es/ posadiplomuarit do të jetë 2100 € e përkrahjes publike (100%).

**4. Investment në prodhimin e energjisë së ripërtritshme:**

4.1. Në kuadër të këtij investimi mbështetet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtriteshme për "vetë-konsum". (d.m.th. kapaciteti prodhues i energjisë e huazuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartën me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, duhet të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.

4.2. Vetë-konsumi duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet / vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së ripërtriteshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vitesh të ndërmarrjes.

**5. Shkalla e përkrahjes publike**

5.1 Intensiteti i ndihmës (ndihma publike) është 50% e shumës së përgjithshme të shpenzimeve të pranueshme për projekt;

5.2 Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 50,000 €;

5.3 Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;

5.4 Përkrahja maksimale publike për periudhën programuese (2023-27) për Masën 3 nuk mund të tejkalojë shumën prej 600,000 € për përfitues;

5.5 Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi (2023-27) në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos e tejkalojë shumën e lartpërmendur;

5.6 Pagesa për Masën 3 bëhet në dy këste: pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;

5.7 Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;

5.8 Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.

**6. Afati i zbatimit**

6.1 Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 11 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në;

6.2 AZHB-ja mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtet e pa përshtatshme klimatike apo sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër. Periudha e fillimit te implementimit përcaktohet me kontratë.

6.3 Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

## KAPITULLI V
## NËN MASAT
## I. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT, MISHIT DHE THERTORET

### Neni 15A
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:**

1.1 Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i aprovuar nga AUV-i para datës së aplikimit;

1.2 Aplikuesit e kategorisë "A", "B" dhe "C" nuk janë të pranueshëm në rast të ndërtimit të objektit të ri, ndërsa janë të pranueshëm në rast të rinovimit të objektit ekzistues dhe investimeve në pajisje;

1.3 Aplikuesit e kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Investimet në pajisje/ linja përpunimi për këtë kategori janë të pranueshme nëse në biznes-plan prioritet i është dhënë ndërtimit të objektit.

**2. Investimet e pranueshme:**

2.1.Investimet në ndërtim/rinovim të qumështoreve. Investimet në ndërtim të qumështoreve të reja të pranueshme vetëm për aplikantet te cilët në kohën e aplikimit janë në kategorinë "D";

2.2. Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve; (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000). Nuk financohet certifikimi HACCP dhe/ose ISO 22000;

2.3. Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;

2.4.Investimet në mjete të specializuara të transportit të qumështit nga fermerët në objekt dhe të produkteve të qumështit nga objekti në treg (përfshirë mjetet e specializuara të transportit të ftohtë);

2.5. Investimet në pajisje për prodhime të reja dhe paketime moderne;

2.6.Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;

2.7.Laboratorët dhe pajisje për kontrollin e cilësisë;

2.8. Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

2.9.Investimet në pajisje për ftohje.

2.10. Investimet për marketing.

**2.11. Investimet e pranueshme për nën masën e përpunimit të mishit dhe thertore:**

2.11.1. Investimet në ndërtim/rinovim të objekteve ekzistuese, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje. Investimet në ndërtime te reja, të pranueshme vetëm për aplikantet të cilët në kohën e aplikimit janë në kategorinë "D";

2.11.2. Investimet në pajisje për përpunim të mishit dhe thertoreve;

2.11.3. Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000) ***Nuk financohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000;***

2.11.4. Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;

2.11.5. Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;

2.11.6. Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;

2.11.7. Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;

2.11.8. Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;

2.11.9. Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

2.11.10. Investime në marketing.

## II. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

### Neni 16
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmerisë për nën-masën e përpunimit të pemëve-përfshirë pataten, perimeve dhe pika grumbulluese/depo të prodhimeve bujqësore**

1.1. Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i regjistruar nga AUV-i para datës së aplikimit;

1.2. Në rast të investimit në pika grumbulluese/depo ekzistuese, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 1000 $m^3$. Në rast të zgjerimit të objektit ekzistues ky objekt duhet të ketë kapacitet minimal prej 500 $m^3$, ndërsa objekti i zgjeruar duhet të arrijë kapacitetin minimal 1000 $m^3$.

**2. Investimet e pranueshme:**

2.1. Investimet në rinovim të objekteve për përpunim;

2.2. Investimet në pika grumbulluese/depo të prodhimeve bujqësore lejohet ndërtimi/ zgjerimi /rinovimi dhe investime në pajisje;

2.3.Investimet në linja për konservim/pasterizim të pemëve dhe perimeve;

2.4.Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000); ***Nuk financohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000;***

2.5.Investimet në objekte dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për deponim;

2.6.Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;

2.7. Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, mjete transportuese me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohjes;

2.8.Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;

2.9.Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;

2.10. Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje;

2.11. Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;

2.12. Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

2.13. Investimet në marketing.

## III. SEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

### Neni 17
### Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për prodhim të verës:**

1.1. Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës dhe Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës para datës se aplikimit, prodhuesit e verës duhet që së paku 50% të lëndës së parë (rrushit) t'a sigurojnë nga prodhuesit e tjerë (jo prodhim vetanak).

1.2. Ky kriter nuk vlen për prodhuesit e verës që kanë në pronësi mbi 50 ha me vreshta. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se e kanë deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe të stoqeve të ngelura.

**2. Investimet e pranueshme për prodhimin e verës:**

2.1. Investimet në rinovim të objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;

2.2. Investimet në pajisje për përpunimin e verës;

2.3. Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000) *Nuk financohet certifikimi HACCP dhe/ ose ISO 22000;*

2.4.Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, ambalazhës dhe pajisje të tjera të specializuara;

2.5.Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

2.6.Investimet për pajisje dhe aparatura për kontrollë të cilësisë së verës, përfshirë laboratorët përkatës;

2.7. Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim të prodhimit verës;

2.8. Investimet në marketing.

**3. Kriteret e përzgjedhjes për te gjitha nën masat e Masës 3 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore janë të përcaktuara në Shtojcën II Tabela 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

## KAPITULLI VI
## MASA 5 "PËRGATITJA DHE ZBATIMI I STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT LOKAL – QASJA LEADER"

### Neni 18
### Përfituesit

**1. Përfituesit përfundimtar:**

Përfituesit përfundimtar janë të gjitha GLV-të e përzgjedhura dhe RrZhR i GLV-ve.

**2. Aktiviteti 1 . Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve në territoret e GLV-ve**

2.1 Qëllimi i këtij aktiviteti është mbështetja e ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve të përzgjedhura si dhe të banorëve të zonave rurale në mënyrë që të rrisin aftësitë e tyre në demokracinë lokale dhe të qeverisjes për të inkurajuar ata që të promovojnë iniciativat lokale dhe partneritetin.

**3. Aktivitetet e pranueshme**

3.1 Përgatitja e studimit për zonën si: studime socio-ekonomike, regjionale, të marketingut;

3.2 Trajnimi dhe shkollimi /edukimi i punonjësve dhe anëtarëve të GLV-ve në bazë të temave të ndryshme;

3.3 Temat e ndërlidhura me qasjen LEADER, si: koncepti LEADER, qeverisja lokale, SZhL, menaxhimi i rrjeteve, avancimi i pjesëmarrjes së palëve me interes;

3.4 Temat e ndërlidhura me menaxhimin, si: përgatitja e planeve të biznesit, përgatitja e aplikacioneve për projekte, kontabiliteti dhe raportimi;

3.5 Tërheqja e interesimit, organizimi i publicitetit dhe materialet e ngjarjet promovuese për anëtarët e GLV-ve dhe banorët e zonës, siç janë: seminaret, punëtoritë, mbledhjet;

3.6 Pjesëmarrja e anëtarëve të GLV-ve në seminare, punëtori, mbledhje, vizita studimore, duke përfshirë ngjarjet e organizuara nga Rrjeti për Zhvillim Rural.

4. **Lista indikative e shpenzimeve të pranueshme**

4.1 Shërbimet e ekspertëve me CV-i të verifikuar të fushave të zhvillimit ekonomik, rural, regjional, mjedisit, marketingut;

4.2 Shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë;

4.3 Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të GLV-ve të përzgjedhura brenda Kosovës dhe jashtë duke përfshirë akomodimin dhe mëditjet;

4.4 Aktivitetet e nxitjes së interesimit, siç janë trajnimet, pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe panaire, parapagimi për publikime dhe blerja e tyre, aktivitete të tjera të zgjimit të interesimit;

4.5 Punëtoritë dhe ngjarjet informative për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të popullatës rurale ne proceset e zhvillimit lokal;

4.6 Marrja me qira e objekteve dhe pajisjeve për organizime të ndryshme, si dhe shërbimet hoteliere;

4.7 Prodhimi dhe publikimi i materialeve siç janë: fletëpalosje, broshura;

4.8 Shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë së GLV-se (dokumentohet me pasqyrën bankare vjetore të GLV-se).

**5.Aktiviteti 2 "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal"**

5.1Brenda Aktivitetit 2 janë dy nën-aktivitete:

**5.1.1 Nën-aktiviteti 2a)**

**5.1.1.1.Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.** Shpenzimet operative të GLV-ve lidhen me menaxhimin dhe funksionalizimin e GLV-ve sipas qasjes LEADER dhe fillimin e zbatimit të SZhL-ve.

**6.Aktivitetet e pranueshme:**

6.1 Hapja e zyrës së GLV-së, duke përfshirë pajisjet dhe mobilet e zyrës;

6.2 Punësimi i punonjësve - menaxherit me orar të plotë ose gjysmë orari;

6.3 Qiraja e zyrës dhe shpenzimet vjetore rrjedhëse, si: materiali për zyrë, rryma, telefoni, interneti;

6.4 Caktimi i buxhetit për shërbimet e tjera të jashtme, si TI, kontabilitet, etj.;

6.5 Shpenzimet e aktiviteteve për menaxherin dhe anëtaret e bordit, si udhëtimit për takime jashtë zyrës, p.sh me GLV tjera etj.;

6.6 Identifikimi dhe caktimi i buxhetit për projektet e vogla që do të zbatohen drejtpërdrejtë.

7. **Lista indikative e shpenzimeve të pranueshme:**

7.1 Pagat e menaxherit të GLV-së dhe/ose të punonjësve të tjerë të GLV-ve;

7.2 Qiraja e zyrës dhe shpenzimet operative;

7.3 Materiali për zyrë;

7.4 Blerja e pajisjeve, duke përfshirë pajisjet e TI-së, mobilet;

7.5 Shërbimet për specialistët e TI-së, kontabilistët;

7.6 Shpenzimet e paparashikueshme;

7.7 Shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë së GLV-s (dokumentohet me pasqyrën bankare vjetore të GLV-së)

8. Nën-aktiviteti 2b)

**8.1 Përkrahja për zbatimin e SZhL-ve të GLV-ve**

8.1.1. GLV-të zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZhL-të. Aktivitet e tilla duhet të mbështesin ngjarje kulturore (panaire, festivale ekspozita etj.), promovim i produkteve vendore (etiketim, marketing, fletëpalosje, broshura etj.), infrastrukturë të shkallës së vogël (gardhiqe, fontanta, parqe, ura të vogla, rrugë fushore, shënjimi i rrugëve malore, rinovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore etj.).

8.1.2. Shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë së GLV-se (dokumentohet me pasqyrën bankare vjetore të GLV-se).

9. Për Aktivitetin 1. “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të territorit të GLV-ve për GLV-të e përzgjedhura”. Shkalla e përkrahjes publike do të jetë 100%.

10. Për Aktivitetin 2. “ Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal- qasja LEADER”

10.1 Nën-aktiviteti 2a) “Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura” duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre. Shkalla e përkrahjes publike do të jetë 100%.

10.2 Nën-aktiviteti 2b) “Zbatimi i SZhL të GLV-ve të përzgjedhura” ku promovojnë dhe zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZHL-të. Shkalla e përkrahjes publike do të jetë 80% nga MBPZHR dhe 20 % nga donatorët tjerë apo nga anëtarët e GLV-ve të përzgjedhura.

11. GLV-të e përzgjedhura zbatojnë programin sipas qasjes prej poshtë-lartë. Vendimet lidhur me elaborimin dhe zbatimin e strategjive zhvillimore lokale duhet të merren nga bordi kryesues i GLV-së përmes shumicës së thjesht të votave.

**12. Ndarja e buxhetit sipas aktiviteteve:**

12.1 Aktiviteti 1; “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit për GLV-të e përzgjedhura”

12.2 Aktiviteti 2; “Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal” në total për vitin 2024 është 300,000.00€.

**13. Aktiviteti 1 “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit të GLV-ve për GLV-të e përzgjedhura”**

13.1 Aktiviteti 1 do të ketë tri pragje të shpenzimeve maksimale të pranueshme varësisht nga numri i banorëve të territorit që përfshinë GLV-ja e përzgjedhur.

13.2 Në bazë të raportit të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës, 2013 nëpër komuna ku GLV-të janë përzgjedhur është si vijon:

13.2.1 Për komuna prej 10,000 deri në 50,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve të pranueshme për Aktivitetin 1. “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura shpenzimet e pranueshme janë deri në euro: 7,000 €

13.2.2 Për komuna me mbi 50,000 deri në 90,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve deri në: 9,000 €;

13.2.3 Për komuna me mbi 90,000 deri në 150,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve deri në: 12,000€;

13.2.4 Dhe për RrZhR deri në 7,000 €. Në momentin e aplikimit duhet të ketë të përgaditur një “Plan pune për aktivitete 5 vjeçare”.

**14. Aktiviteti 2 “Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal”**

14.1 2a) Nën aktiviteti i parë është “Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura” duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.

14.2 b) Nën aktiviteti i dytë që është “Zbatimi i SZHL të GLV-e të përzgjedhura” ku promovojnë dhe zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZHL.

**15.** Administrimi i shpenzimeve të pranueshme

15.1 Aktiviteti 1 “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura” ;

15.2 GLV–të e përzgjedhura pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, 80% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme i marrin si paradhënie;

15.3 Ndërsa pas përfundimit të projektit, GLV-ja përfituese duhet të sjellë dëshmitë e nevojshme, si: faturat, formularin e ditëve të punës të menaxherit dhe të ekspertëve, si dhe CV-në e menaxherit, CV-në e ekspertit si dhe procedurën e përzgjedhjes së menaxherit apo

ekspertit, si për mjetet e marra në paradhënie ashtu edhe për 20% të mjeteve të cilat paguhen pas përfundimit të projektit. Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, GLV-ja përfituese obligohet të kthej mjetet e marra;

15.4 Ndihma publike nga MBPZHR jepet në dy këste: 80% si paradhënie dhe 20 % pas përfundimit të projektit;

15.5 Aktiviteti 2 "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal- qasja LEADER"

15.6 Nën-aktiviteti 2a) "Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura" duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.

15.7 GLV–të e përzgjedhura pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, 80% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme i marrin si paradhënie.

15.8 Ndërsa pas përfundimit të projektit, GLV-ja përfituese duhet të sjellë dëshmitë e nevojshme, si: faturat, formularin e ditëve të punës të menaxherit dhe të ekspertëve, si dhe CV-në e menaxherit, CV-në e ekspertit si dhe procedurën e përzgjedhjes se menaxherit apo ekspertit, si për mjetet e marra në paradhënie ashtu edhe për 20% të mjeteve të cilat paguhen pas përfundimit të projektit. Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, GLV-ja përfituese obligohet të kthejë mjetet e marra.

15.9 Shkalla e përkrahjes publike do të jetë 100%. Ndihma publike nga MBPZHR jepet në dy këste: 80% si paradhënie dhe 20 % pas përfundimit të projektit.

15.10 Nën-aktiviteti 2b) "Zbatimi i SZhL të GLV-ve të përzgjedhura" ku promovojnë dhe zbatojnë projekte të vogla në përputhje me SZHL-të.

15.11 Shkalla e përkrahjes publike do të jetë 80% nga MBPZHR dhe 20 % nga donatorët tjerë apo nga anëtarët e GLV-ve të përzgjedhura. Përzgjedhja e projektit bëhet nga GLV-ja .

15.12GLV-të duhet të bëjnë kërkesën për pagesë edhe për paradhënie.

## 16 Shtrirja gjeografike e masës

16.1 GLV-të e përzgjedhura mbulojnë 12 komunat përkatëse të Kosovës, në të cilat ato veprojnë.

16.2 Një GLV përfaqëson një zonë rurale me popullatë prej më shumë se 10 .000 banorë dhe më pak se 150.000, duke përfshirë qytezat dhe qytetet me më pak se 30.000 banorë.

16.3 Territori i përfaqësuar nga GLV-ja duhet të jetë integral nga pikëpamja ekonomike, shoqërore dhe fizike (gjeografike) dhe nuk duhet t'i përket territorit të GLV-së tjetër.

16.4 Vendi i njëjtë nuk duhet t'i përket më shumë se një GLV-je, d.m.th. një partneriteti, një strategjie dhe një territori.

**17 Afati i zbatimit të projekteve**

Zbatimi i projekteve zgjatë 12 +2 muaj prej momentit të nënshkrimit të kontratës.

## KAPITULLI VII
## MASA E MENAXHIMIT TË RREZIKUT NË BUJQËSI - SIGURIMET BUJQËSORE

### Neni 19
### Përfituesi

1. **Përfituesit**

   Përfituesit përfundimtar në këtë masë janë fermerët (personat fizik dhe juridik), sipas përkufizimit të përcaktuar nga Ligji nr.08/l-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023), të cilët i sigurojnë kulturat bujqësore.

2. **Kriteret e pranueshmërisë**

   2.1 Të gjithë fermerët që marrin polisen e sigurimit, duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës;

   2.2 Të kenë të siguruara kulturat bujqësore të cilat përkrahen me këtë masë;

   2.3 Të drejtë për aplikim kanë kompanitë e sigurimit të autorizuara nga fermeri përmes deklaratës së zotimit;

   2.4 Të drejtë përfitimi kanë fermerët të cilët plotësojnë kriterin e pranueshmërisë së siperfaqes për pagesa direkte/ subvencione nga lista e kulturave të cilat mbështeten përmes sigurimeve bujqësore.

3. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

   3.1 Kopja e Certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;

   3.2 Licenca e BQK-se për sigurime bujqësore;

   3.3 Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së;

   3.4 Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (E pronarit apo përfaqësuesit të kompanisë);

   3.5 Polisat e Sigurimit konform kritereve të përcaktuar tek kriteret e veçanta për kulturat bujqësore të siguruara, përfshirë listën e fermerëve me të dhënat e nevojshme përfshirë NIF;

   3.6 Dëshmi mbi pagesën e polisës së sigurimit;

   3.7 Deklarata e zotimit e nënshkruar nga të dy palët (fermeri dhe kompania e sigurimit).

**4. Kriteret e veçanta të pranueshmerisë duhet të jenë në harmoni me kriteret e pranueshmerisë tek pagesat direkte/në baza vjetore.**

**5.** Të gjithë fermeret qe marrin polisen e sigurimit, duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës.

**6. Investimet e pranueshme të përbashkëta për masën**

Në kuadër të kësaj mase mbështetëse, vetëm shpenzimet e ndërlidhura me sigurimin bujqësor janë të pranueshme, respektivisht vetëm shpenzimet që krijohen me rastin e blerjes së polisës së sigurimit bujqësor indeks apo tradicional.

**7. Kriteret e përzgjedhjes**

7.1 Pas pranimit të kërkesës për pagesën e mbështetjes, AZHB kryen kontrollin administrativ i cili përfshin kontrollin e pranueshmërisë së përfituesit dhe kostove, bazuar në kërkesën dhe dokumentacionin e ngarkuar në kërkesën për pagesën e mbështetjes;

7.2 Të drejtë përfitimi kanë të gjithë aplikuesit të cilët i plotësojnë kriteret.

**8. Shkalla e përkrahjës publike**

Përkrahja publike indikative për këtë masë është 75% të shpenzimeve të pranueshme.

**9. Afati i zbatimit**

**10.** Afati i zbatimit ndërlidhjes me periudhën e shitjeve të polisave të sigurimit, qe do të përcaktohet ne udhëzuesin për aplikues për këtë masë.

10.1. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë.

## KAPITULLI VIII
## PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE

### Neni 20
### Zbatimi

1. Procedura për zbatimin e PZHR 2024 bëhet sipas Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/29 Mars 2023), Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21/qershor 2016), Ligjit Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta Zyrtare Nr.26/29 Dhjetor 2023) sipas këtij udhëzimi administrativ dhe legjislacionit në fuqi.

2. Masat 1, 3, 5 dhe Masa e menaxhimit të rrezikut në bujqësi - sigurimet bujqësore zbatohen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

### Neni 21
### Thirrja për Aplikim

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjëse për hartimin, publikimin e thirrjes për aplikim dhe udhëzuesit për aplikues, në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

**Neni 22**
**Procedura e dorëzimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve**

1.Procedurat e dorëzimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve janë:

1.1. Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-së: www.azhb-ks.net, në të cilën gjindet linku "aplikimi online" që dërgon në modulin e aplikimit online. Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF.

1.2. Pas përfundimit të procesit të aplikimit online nga nën paragrafi 1.1 i këtij neni, fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

1.1. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve;

1.2. Shpallja publike e rezultateve preliminare të vlerësimit të projekteve;

1.3. Njoftimi i fermerit me rezultatin e vlerësimit të projektit;

1.4. Periudha e ankimimit/ E drejta e ankesës;

1.5. Kontrolla e parë në terren;

1.6. Miratimi / Refuzimi i projekteve;

1.7. Periudha e ankimimit;

1.8.Nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe AZHB-së;

1.9. Koha e kryerjes së investimeve;

1.10. Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga përfituesi bëhet në AZHB;

1.13. Kontrolli administrativ i pakos së kërkesës për pagesë;

1.14. Kontrolla e dytë në terren;

1.15. Masat ndëshkimore në rast të parregullësive gjatë zbatimit të projekteve;

1.16. Autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës;

1.17. Kontrolla pas zbatimit të projektit;

1.18. Vendimi për kthimin e mjeteve financiare;

1.19. E drejta e ankesës.

2. Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe prej 45 ditëve, pas përfundimit të procesit të aplikimit deri tek raporti i vlerësimit/publikimi i rezultateve preliminare mbi përkrahjen, në pajtim me nenin 98 Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

3. Në rastet e kompleksitetit të çështjes administrative, afati mund të shtyhet bazuar në nenin 99 të Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Neni 23**
**Dorëzimi i aplikacioneve**

1. Aplikimi online duhet të ketë të ngarkuara të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit për aplikim;

2. Në aplikacionin online duhet të përfshihen projekti me të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim;

3. Aplikuesi mund të aplikoj vetëm një herë brenda programit për zhvillim rural 2024;

4. Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri, nëse projekti i mëparshëm nuk është përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në;

5. Aplikuesi siguron që të gjitha informatat dhe dokumentet e dhëna janë të qarta dhe të sakta;

6. Aplikuesi pranon një njoftim online përmes e-mailit për dorëzimin e aplikacionit;

7. Ne rast te paraqitjeve të problemeve teknike me rastin e pranimit të aplikacionit, gjatë kontrollit administrativ kërkohet sqarim nga divizioni i IT-së.

8. Në rast kur aplikuesit i mungojnë dokumentet të cilat gjenerohen nga MBPZHR të cilat janë të listuar në udhëzues për aplikues, aplikuesit informohen nga AZHB-ja dhe u ipet afat prej 5 ditësh për t'i sjellë në AZHB.

**Neni 24**
**Kontrolli, vlerësimi dhe miratimi i aplikacioneve në AZHB**

1. Kontrolli dhe vlerësimi i aplikacioneve duhet të filloj pas mbylljes së afatit për aplikim;

2. Aplikacionet e kompletuara i nënshtrohen vlerësimit të mëtutjeshëm të shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare;

3. Nëse projekti apo kërkesa është vlerësuar nga ekspertët e fushës përkatëse, shqyrtimi i projektit apo i kërkesës shtyhet deri sa ekspertët e fushës përkatëse të ofrojnë rekomandim;

4. Pranueshmëria e shpenzimeve kontrollohet dhe miratohet, duke i krahasuar me çmimet referente / çmimoret e aprovuara nga MBPZHR;

5. Një projekt/aplikacion mund të përzgjidhet për mbështetje vetëm nëse arrin pragun minimal prej 50 pikësh deri në pragun maksimal prej 100 pikësh. Pragu minimal vendoset për të siguruar që projektet e përkrahura sjellin vlerë të shtuar të mjaftueshme për sektorin;

6. Pas vlerësimit dhe poentimit të projekteve, bëhet shpallja publike e listës preliminare të vlerësimit të projekteve të zhvillimit rural në web-faqen zyrtare të MBPZHR-së dhe AZHB-së;

7. Njoftimi për publikimin e listës preliminare të përfituesve të mundshëm listës së vlerësimit të aplikimeve të projekteve të zhvillimit rural bëhet në web-faqen zyrtare të MBPZHR-së dhe AZHB-së;

8. AZHB përmes postës elektronike dhe mesazheve SMS duhet t'i njoftojë të gjithë aplikuesit për publikimin e listës së vlerësimeve preliminare të projekteve të zhvillimit rural po atë ditë;

9. Aplikuesit që konsiderohen përfitues të mundshëm kanë të drejtë që brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga dita e marrjes së njoftimit të paraqiten në AZHB për të marrë letrën informuese dhe vlerësimin e projektit të tyre;

10. Afati i ankimimit fillon të rrjedhë ditën e nesërme, pas publikimit të listës preliminare të përfituesëve të mundshëm të projekteve të zhvillimit rural;

11. Në të njejtën ditë Lista me përfituesit e mundshëm / projektet e përzgjedhura dërgohet tek Drejtorati i Kontrollës në AZHB për kontrollën e parë në terren, e cila duhet të fillojë menjëherë;

12. Në bazë të raportit të kontrollës së parë në terren dhe raportit të procesit të ankimimit, bëhet miratimi i projekteve të zhvillimit rural për financim dhe aprovohet Lista përfundimtare e përfituesëve të projekteve të zhvillimit rural, e cila duhet të publikohet në uebfaqen e MBPZHR-së dhe të AZHB-së;

13. Të gjithë aplikuesit duhet të informohen për përzgjedhjen ose refuzimin e projektit të tyre;

14. Pas miratimit të projekteve, hartimit të Listës përfundimtare të përfituesëve të projekteve të zhvillimit rural dhe njoftimit të aplikuesëve përfitues, bëhet nënshkrimi i kontratës ndërmjet përfituesit dhe AZHB-së;

15. Aplikanti ftohet të nënshkruaj kontratën për bashkë – financim të projektit brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të letër imformimit për miratimin e projekteve;

16. Pas nënshkrimit të kontratës, përfituesi është i obliguar që të fillojë zbatimin e projektit sipas kontratës.

**Neni 25**
**Refuzimi i projekteve**

1. Aplikuesi refuzohet nëse:

 1.1.Dokumentacionin e ka të pa kompletuar;

 1.2. Dështon t'i plotësojë kriteret e pranueshmërisë;

 1.3. Shpenzimet nuk mund të verifikohen si të pranueshme;

1.4. Projekti nuk është i qëndrueshëm ekonomikisht sipas AZHB-së;

1.5. Në rast të mashtrimit në çdo fazë të procedurës;

1.6. Nëse projekti i financuar nga përkrahja publike nuk është funksional sipas projektit/ plan biznesit dhe kontratës;

1.7. Në rast të mos respektimit të kushteve të kontratës për financim të projektit.

2. Aplikuesi i cili aplikon për investime publike gjithashtu do të refuzohen nëse dështon të kryej procesin e prokurimit sipas rregullave të aplikueshme të prokurimit.

2.1.Në rast se aplikuesi aplikon për të njejtat investime për të cilat ka përfituar nga vitet paraprake – Bazuar në periudhën e amoritizimit;

2.2.Aplikuesi njoftohet për projektin që është refuzuar me anë të vendimit për refuzim të nxjerrë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

2.3.Vendimi për refuzim përmbanë arsyet e refuzimit në mënyrë të detajuar.

**Neni 26**
**Shpenzimet e papranueshme për masat**

1. Shpenzimet e papranueshme për masat, perveq nëse është parapare ndryshe ne masën specifike janë:

1.1 Taksat, përfshirë TVSH-në; me përjashtim të TVSH–së pa – kthyeshme për personat fizikë dhe ndërmarrjet jo-raportuese të TVSH-së;

1.2 Taksat doganore dhe akcizat;

1.3 Blerja dhe qiraja e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;

1.4 Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;

1.5 Shpenzimet operative;

1.6 Makineri dhe pajisje e përdorura;

1.7 Detyrimet bankare, kamatat, shpenzimet e garantuesit dhe detyrimet e ngjashme;

1.8 Kostot e këmbimit, detyrimet dhe humbjet e këmbimit, si dhe shpenzime tjera financiare;

1.9 Kontributet në natyrë;

1.10 Shpenzimet për transport;

1.11 Blerja e inputeve bujqësore, bimëve njëvjeçare, bimëve dekorative dhe mbjellja e tyre;

1.12 Shpenzimet e përgjithshme që ndërlidhen me shpenzimet për tarifat e arkitektëve, inxhinierëve, studime fizibiliteti, konsulencë për përgatitjen e planit te biznesit, zbatim dhe

mirëmbajtje te projektit  dhe shpenzimet administrative qe ndërlidhen me lejen e ndërtimit, pëlqimit mjedisore, ndërrimit te desitinacionit të tokës, kadastrit, janë shpenzime te pa pranueshme;

1.13  Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe amortizimit;

1.14  Shpenzimet për pagat e stafit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, implementimit, monitorimit dhe kontrollimit;

1.15  Shpenzimet nga paragrafi 1.3 dhe 1.5 të këtij neni përveç  blerjes së tokës dhe ndërtesave,  janë të pranueshme në kuadër të masës "Implementimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – Qasja LEADER", Përmirësimi i Trajnimit" dhe " Mbështetja për krijimin e grupeve të prodhuesve".

**Neni 27**
**Kërkesa për pagesë**

1.  Përfituesit që kanë përfunduar investimin sipas kontratës e dorëzojnë kërkesën për pagesë në Zyret Regjionale të AZHB-së.

2. Formulari i kërkesës për pagesë mund të shkarkohet nga web-faqja e AZHB-se apo sigurohet nga Zyra Regjionale e AZHB-së.

3. Kërkesa për pagesë me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet kopje fizike, dhe një CD apo USB me dokumentet e skanuara, personalisht nga përfituesi ose nga personi i autorizuar. siç është përcaktuar në Kontratën për financimin e projekteve.

4. Nëse kërkesa për pagesë nuk është e kompletuar me të gjitha dokumentet sipas kontratës, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon Kërkesën për pagesë, por e regjistron atë duke i dhënë përfituesit një kopje dhe i kërkon plotësimin e dokumentacionit përkatës brenda afatit prej pesë (5) ditëve.

5. Nëse përfituesi brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij Neni, nuk e dorëzon dokumentacionin e kompletuar, kërkesa për pagesë refuzohet.

6. Pas kontrolles administrative të kërkesës për pagesë, Drejtoria e Kontrollit në AZHB bënë kontrollën e dytë në terren për t'u siguruar se investimi është bërë sipas projekt propozimit / biznis planit të aprovuar dhe letrës miratuese.

7. Në rast të gabimve teknike në pakon e kërkesës për pagesë aplikuesi duhet të njoftohet për korigjimin e gabimeve teknike, në afat prej pesë (5) ditëve.

8. Nëse përfituesi brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 7 të këtij neni, nuk e korigjon dokumentacionin me gabime teknike,  ky dokument refuzohet.

9. Në bazë të Vlerësimit të Raportit të Kontrollit nga tereni dhe faturave të dorëzuara, me kërkesën për pagesë dhe çmimores së AZHB-së,  AZHB nxjerrë Vendim për pagesë brenda afatit 60 ditësh dhe e njofton përfituesin përmes një Letre Informuese.

10. Asnjë pagesë nuk bëhet për përfituesit për të cilën konstatohet se kanë krijuar kushte artificiale për marrjen e pagesave.

11. Nëse kërkesa për pagesë nuk është pranuar apo mbështetja publike është zvogëluar, përfituesi duhet të informohet përmes Letrës informuese.

12. Prej ditës së dorëzimit të kërkesës për pagesë deri te ekzekutimi i pagesës nuk duhet të kalojnë më shumë se (90) ditë, përveç nëse një tejkalim i afatit bëhet për arsye objektive.

13. Para kërkesës për pagesë përfituesi duhet të vendos në vend investim tabelen me logo të MBPZHR/AZHB me madhësi 100cmx50cm të përcaktuar sipas Shtojcave 1, 2, 3, 4, dhe 5 të këtij udhëzimi adminsitrtaiv.

14. Pagesa duhet të bëhet në afat prej (30) ditësh nga dita e Vendimit për pagesë.

15. Në rast të kontestimit të vendimit për pagesë ose vendimit për refuzim të pagesës, përfituesi ka të drejtë ankese.

16. AZHB krijon një Komision të veçantë për ankesa në përbërje prej tre (3) anëtareve që ndërlidhen me vendimin për nderprerje të kontratës, vendimin për pagesë, vendmin për refuzim dhe vendimit për përjashtim për tri vite.

17. Kundër vendimit të Komisionit pala ka të drejtë të ushtrojë padi për konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

## Neni 28
## Shkalla e kontrolleve në teren

1. Projektet e përzgjedhura për financim ju nënshtrohen kontrolleve në terren për të verifikuar gjendjen faktike të propozimeve për investime, nëse informacioni në dokumentet e parashtruara korrespondon me gjendjen reale.

2. AZHB obligohet të kontrollojë në teren në shkallën prej 100 % të gjitha projektet, të cilat janë përzgjedhur si përfituese nga PZHR 2024 dhe të verifikojë përmbushjen e kritereve për financim.

3. Pas parashtrimit të Kërkesës për pagesë, Drejtoria e Kontrollit e AZHB-së është i obliguar të verifikojë zbatimin e investimeve me anë të kontrollit në teren. Në këtë rast përfituesi është i obliguar të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të kontollës në teren më së largu 5 ditë nga njoftimi i AZHB-së.

4. Rikontrolli në terren bëhet në raste të caktuara dhe me kërkesë të Drejtorive përkatese të AZHB-së.

5. Në bazë të raportit të kontrollit për verifikimin, kërkesës për pagesë me dokumentacionin e bashkangjitur për kryerjen e investimeve dhe çmimoren referente, bëhet autorizimi i pagesës.

6. AZHB kryen Ex-post kontroll  për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim se paku pesë (5) vite, nga dita e ekzekutimit të pagesës së fundit. Në këtë rast përfituesi

është i obliguar të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të kontolles në teren më së largu 5 ditë nga njoftimi i AZHB-së.

7. AZHB me vendim të veçantë e cakton komisionin për supërkontoll të projekteve.

**Neni 29**
**Kontrolla e veçantë**

Për kontrollën e veçantë në terren, në rastet të investimeve në ndërtimtari dhe investimeve që kërkojnë ekspertizë të veçantë, AZHB mund të angazhojë ekspert të fushave përkatëse për të dhënë vlerësim profesional.

**Neni 30**
**Dokumentacioni i kërkuar për pagesë**

1. Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë origjinalin e dokumenteve të kërkuara sipas kërkesës për pagesë dhe një CD me dokumentet e skanuara.

2. Pagesat mbi shumën treqind euro (300.00€), bëhen përmes transferit bankar dhe duhet të vërtetohen me pasqyrat bankare të llogarisë rrjedhëse.

3. Për pagesat me vlerë nën treqind euro (300.00€) nëse pagesa është bërë me para në dorë, duhet të sigurohet fatura dhe kuponi fiskal, kurse nëse pagesa është berë përmes bankës duhet të dorëzohet fletepagesa e transferit bankar.

**Neni 31**
**Procedura e ankesave për aplikues**

1. Aplikuesit e pakënaqur me rezultatin e vlerësimit kanë të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të AZHB-së.

2. Ankesa duhet t'i drejtohet Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.

3. Aplikuesi mund të paraqesë ankesë me shkrim në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të Listës preliminare të përfituesëve të mundshëm të projekteve të zhvillimit rural.

4. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës, duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës.

5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij, me të cilin:

5.1. Refuzon ankesën ndaj vendimit të AZHB-së në lidhje me vlerësimin e projektit përkatës.

5.2. Aprovon ankesën dhe anulon vendimin e AZHB-së në lidhje me vlerësimin e projektit përkatës dhe merr vendim meritor.

6. Gjatë procesit të shyqrtimit të ankesave, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave mund të kërkojë informacione të nevojshme nga AZHB, të realizojë vizita në terren dhe të kërkojë informata të drejtpërdrejt nga pala në lidhje me projektet përkatëse.

7. Kundër vendimit përfundimtar në procedurë të rregullt administrative nuk lejohet ankesë por me padi mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

**Neni 32**
**Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave**

1. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave është një trup profesional për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen për ankesa, i cili përbëhet nga zyrtarë të AZHB-së dhe MBPZHR-së dhe themelohet me vendim të MBPZHR-së.

2. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave përbëhet nga pesë (5) anëtarë, dy (2) prej të cilëve janë zyrtarë në AZHB, ndërsa tre (3) prej të cilëve janë zyrtarë të MBPZHR-së.

3. Anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave janë të pavarur në punën e tyre dhe vendimet i marrin në pajtim me faktet dhe gjendjen e verifikuar.

4. Anëtari i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që:

4.1. Të zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;

4.2. Të jetë i paanshëm;

4.3. Të ushtrojë të drejtën e votës së lirë dhe të pandikuar;

4.4.Të marrë pjesë në takimet e Komisionit dhe të nënshkruaj raportet punuese dhe vendimet përkatëse.

5. Komisioni për ankesa nga paragrafi 2 i këtij neni obligohet që vendimet e marra t'i hartojë në pajtim me arsyetimin e aktit administrativ të përcaktuar në nenin 48 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

6. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që për punën e vet dhe për veprimet e marra të hartojë raport me shkrim dhe të informojë zyrtarët më të lartë të MBPZHR-së dhe AZHB-së, si dhe palët e interesit, ne pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Neni 33**
**Trajtimi i lëndëve të gjykatave**

Lënda e cila rikthehet për rishqyrtimi dhe rivendosje me aktgjykim nga gjykata përkatëse duhet të trajtohet dhe përgatitet përgjigje/vendim nga Zyra Ligjore e AZHB-së, ndërsa vendimi nxirret nga Drejtori Ekzekutiv.

**Neni 34**
**Kushtet për mirëmbajtjen e investimit**

1. Investimi për të cilin përfituesi ka marrë mbështetje nuk duhet të pësojë ndryshim thelbësor brenda pesë (5) viteve nga data kur pagesa përfundimtare është pranuar.

2. Ndryshime thelbësore të një investimi janë ato të cilat rezultojnë në:

2.1. Ndërprerjen ose zhvendosjen e aktivitetit prodhues nga paragrafi 1 i ketij neni, në një fushë që nuk është e mbuluar me Program;

2.2. Ndryshimi i pronësisë dhe vendi i investimit;

2.3. Ndryshim përmbajtjesor që ndikon në natyrën, objektivat ose kushtet e zbatimit të cilat rezultojnë me ndryshimin e objektivave fillestare.

3. Në rast të situatave të jashtëzakonshme që mund të ndikojnë në investim nga fatkeqësitë natyrore, përfituesi duhet të informojë AZHB-në brenda afateve, sipas kontratës së nënshkruar nga dy palët.

**Neni 35**
**Kontrolla në terren Ex-posti dhe procedura pas zbatimit të projektit**

1. Përfituesi është i obliguar t'a kthejë mbështetjen financiare pjesërisht apo tërësisht në rast së pas implementimit të kontratës deri në përfundim të periudhës monitoruese/ex-post paraqiten parregullësi.

2. Në rast të evidentimit të parregullësive përfituesi do të ndëshkohet sipas nenit 53 të Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;

3. Përfituesi ka të drejtë ankese ndaj Vendimit si në paragrafin 2 të këtij neni, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të cilin e formon Drejtori Ekzekutiv i AZHB-së në përberje prej 3/5/7 anëtarëve për vendosje në ankesë.

4. Kundër vendimit përfundimtar në procedurë të rregullt administrative nuk lejohet ankesë por me padi mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

5. Pas përfundimit të procedurës së ankesës AZHB është e obliguar që të vazhdojë procedimin e kthimit të përkrahjës publike përmes organeve kompetente.

**Neni 36**
**Zbatimi**

Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, aplikuesit dhe përfituesit nga Masat e Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ.

**Neni 37**
**Dispozitat ndëshkimore**

1. Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në Nenin 53 të Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/27.03.2023) dhe legjislacionit në fuqi.

2. Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendura, AZHB duhet menjëherë të informojë palën për shkelje të kontratës dhe duhet të fillojë procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

**KAPITULLI IX**
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 38**
**Toka nën komasacion**

Përjashtimisht dispozitave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, aplikuesit të cilët e kanë sipërfaqen e tokës bujqësore nën komasacion por nuk e posedojnë kopjen e planit dhe fletën poseduese, por kanë aktvendime të ligjshme të komasacionit nga kadastri, ju lejohet aplikimi për përkrahje në kuadër të PZHR 2024.

**Neni 39**
**Dokumentacioni për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok**

1. Aplikuesit e komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, të cilët nuk mund të sigurojnë fletat poseduese dhe kopjen e planit nga komuna e tyre përkatëse, këto dokumente duhet t'i marrin nga Agjencioni Kadastral i Kosovës.

2. Aplikuesit e komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, ju lejohet të aplikojnë për përkrahje në kuadër të PZHR 2024 pa vërtetim për tatimin në pronë.

**Neni 40**

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë përgatitë udhëzuesit për aplikant për:

1.1.Masën 1 Investimet në Asetet Fizike në Ekonomitë Bujqësore;

1.2. Masën 3 Investimet në Asetet Fizike në Përpunimin dhe Tregtimin e Produkteve Bujqësore;

1.3. Masën 5 Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjive të Zhvillimt Lokal – Qasja Leader,

1.4. Masa e menaxhimit te rrezikut ne bujqesi - sigurimet bujqesore.

2. Aplikuesit janë të obliguar të ju përmbahen udhëzuesve për aplikues të cilët janë të publikuar në ueb faqën e AZHB-së dhe MBPZHR-së.

**Neni 41**
**Shtojcat**

**1.** Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë:

1.1. Shtojca Nr. I Masa 1 - Investimet në Asetet Fizike në Ekonomitë Bujqësore:

1.1.1. Tabela 1: Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor;

1.1.2. Tabela 2: Kriteret e përzgjedhjes për prodhimtarin blegtorale;

1.1.3. Tabela 3: Kriteret e përzgjedhjes për lope qumeshtore;

1.2. Shtojca Nr.II. Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore:

1.2.1. Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për të gjitha nën masat e kësaj mase.

**Neni 42**
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Faton Peci**

________

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural

Data: 17/12/2024

**SHTOJCA I**

## MASA 1 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE-

### 1. Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor

| Nr | Lloji i kritereve | | Kategoria | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Investimet në rritjen e prodhimit, përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë.<br>Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritët. Në rast të investimit në infrastrukturë: depo, ujitje, mbrojtje kundër breshrit dhe/ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese [1] apo asaj që do të ngritet, cila do qoftë më e madhe. | Drufrutore | Manore | Rrush | Drithërat (grurë dhe misër): | Serra/serra për fidanë | Depo për peme, perime (përfshirë pataten), rrush, | Pikët |
| | | ≥ 3 ha | ≥ 0.5 ha | ≥ 1 ha | > 50 ha | > 0.20 ha | Sipërfaqja e ngritur, përfshirë edhe atë ekzistuese, më e madhe se 5 ha | 45 |
| | | 1 ha - < 3 ha | 0.35 ha - < 0.5 ha | 0.5 - 1 ha | 30 – 50 ha | 0.10 – 0.20 ha | Sipërfaqja e ngritur, përfshirë edhe atë ekzistuese nga 3- 5 ha | 40 |
| 2. | Aplikuesi i ri[2] | Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri | | | | | | 5 |
| 3. | Gjinia e fermerit | Aplikuesi femër - pikët e këtij kriteri merren nëse toka/vendi ku bëhet investimi është në emër të aplikueses, në tri vitet e fundit. | | | | | | 5 |
| 4. | Investimet në zonat malore - ky kriter nuk vlen për aplikuesit për serra dhe për drithëra | Investimet në zonat malore | | | | | | 15 |
| 5. | Investime që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike[3] | Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtëritshme *(min. 5% por jo më shumë se 50% të investimit vlerës së përgjithshme të projektit )* | | | | | | 5 |
| 6. | Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës. | Vendet e punës do të vlerësohen duke u bazuar në tabelën e cila është e paraqitur në udhëzues për aplikues, por jo më shumë se që janë deklaruar në biznes plan. Për çdo punëtor të punësuar, aplikuesi merr nga 5 pikë shtesë, por jo më shumë se 20 pikë. | | | | | | 20 |
| 7. | Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit. | Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit. | | | | | | 5 |
| | **GJITHSEJ** | | | | | | | **100** |

1 Sipërfaqet ekzistuese të dëshmohen me marrjen e pagesës direkte kjo vlen edhe për investimeve ne ndërtimin e depove dhe blerjes se traktorit.

2 I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

3 Investimet në prodhimin e energjisë së ripëtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilido kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit te kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit ne fuqi.

### 1.1 Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin shtazor

<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Lloji i kritereve</th><th colspan="6">Kategoria</th></tr>
<tr><td rowspan="3">1.</td><td rowspan="3">Kapaciteti prodhues<br>(numri i kafshëve) pas realizimit të projektit.</td><td>Pikat grumbulluese të qumështit</td><td>Viça</td><td>Derra</td><td>Dele/dhi</td><td>Pula</td><td>Pikët</td></tr>
<tr><td>≥ 5 < 15 fermerë</td><td>≥ 20 < 30 krerë</td><td>≥ 40 < 100</td><td>≥ 130 < 300</td><td>≥ 5000 < 50.000</td><td>15</td></tr>
<tr><td>≥ 15 fermerë</td><td>≥ 30 krerë</td><td>≥ 100 krerë</td><td>≥ 300 krerë</td><td>≥ 50.000 krerë</td><td>20</td></tr>
<tr><td rowspan="2">2.</td><td rowspan="2">Investimet në rritjen e prodhimit në përmirësimin e efikasitetit. Lloji i investimit:<br>Në rast të investimit edhe nga pika a) dhe pika b) pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të buxhetit të planifikuar në biznes plan.</td><td colspan="5">a) Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallës apo pikës grumbulluese të qumështit</td><td>25</td></tr>
<tr><td colspan="5">b) Makineri dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme, depo e plehut, depo e silazhit, dhe depo e sanës</td><td>20</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>Investime që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike[4]</td><td colspan="5">Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtëritshme (min. 5% por jo më shumë se 50% të investimit vlerës së përgjithshme të projektit )</td><td>5</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Investimet në zonat malore</td><td colspan="5">Investimet në zonat malore</td><td>15</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës</td><td colspan="5">Vendet e punës do të vlerësohen duke u bazuar në tabelën e cila është e paraqitur në udhëzues për aplikues, por jo më shumë se që janë deklaruar në biznes plan. Për çdo punëtor të punësuar, aplikuesi merr nga 5 pikë shtesë, por jo më shumë se 20 pikë.</td><td>20</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit.</td><td colspan="5">Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit.</td><td>5</td></tr>
<tr><td>7.</td><td>Aplikuesi i ri</td><td colspan="5">Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri[5]</td><td>5</td></tr>
</table>

4 Investimet në prodhimin e energjisë së ripëtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilido kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit te kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit ne fuqi.

5 I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8. | Gjinia e fermerit | Aplikuesi femër - pikët e këtij kriteri merren nëse e toka/vendi ku behet investimi është ne emër te aplikueses, ne tri vitet e fundit. | 5 |
| **GJITHSEJ** | | | **100** |

### 9.2.1 Kriteret e përzgjedhjes për lopë qumështore

| Nr. | Lloji i kritereve | Kategoria | |
|---|---|---|---|
| 1. | Kapaciteti prodhues<br>(numri i kafshëve te blera me projekt) | Lopë qumështore[6] | Pikët |
| | | 5- 10 krerë mëshqerra barrëse/Lope qumështore. | 50 |
| | | 11-20 krerë mëshqerra barrëse/Lope qumështore. | 45 |
| | | 21-25 krerë mëshqerra barrëse/Lope qumështore. | 40 |
| 2 | Investimet në zonat malore | Investimet në zonat malore | 10 |
| 3 | Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan. | Vendet e punës do të vlerësohen duke u bazuar në tabelën e cila është e paraqitur në udhëzues për aplikues, por jo më shumë se që janë deklaruar në biznes plan. Për çdo punëtor të punësuar, aplikuesi merr nga 5 pikë shtesë, por jo më shumë se 20 pikë. | 20 |
| 4 | Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit. | Aplikuesi nuk ka përfituar grant në 3 vitet e fundit. | 5 |
| 5 | Sigurimi i bazës ushqyse | Së paku 0.5 ha për krer te lopës/mëshqerra [7] | 5 |
| 6 | Aplikuesi i ri[8] | Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri | 5 |

6 Ne këtë grup hyjnë edhe fermerët fillestar, te cilët janë te obliguar te arrijnë numrin minimal prej 10 krerëve pas zbatimit te projektit.

7 Së paku 0.5 ha tokë në pronësi apo të trashëguar për krer te lopës/mëshqerra të shtuara me projket

8 I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7 | Gjinia e fermerit | Aplikuesi femër - pikët e këtij kriteri merren nëse e toka/vendi ku behet investimi është ne emër te aplikueses, ne tri vitet e fundit. | 5 |
| **GJITHSEJ** | | | **100** |

**SHTOJCA II**
**MASA 3 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE**:

Tabela nr 4. Kriteret e përzgjedhjes për të gjithë nën sektorët

| Nr | Kriteret e përzgjedhjes | Pikët |
|---|---|---|
| 1. | Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit | 25 |
| 2. | Investimet në projekte për përmirësim të pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara)[9] | 15 |
| 3. | Investimi në prodhimin e energjisë në ndërmarrje nga burimet e ripërtëritshme *(min. 10% por jo më shumë se 50% të investimit vlerës së përgjithshme të projektit )*[10] | 20 |
| 4. | **Investimet që kanë të bëjnë me trajtimin** e mbetjeve; pastrimin e ujërave te shkarkuara dhe/ose trajtimin e mbetjeve (brenda biznesit te aplikuesit) *(min. 5% por jo më shumë se 50% të investimit vlerës së përgjithshme të projektit )* | 15 |
| 5. | Investime që shpijnë në inovacion dhe diversifikim të prodhimit<br>Futja e të paktën dy produkteve të reja (ose dy lloje te ndryshme të verërave) | 10 |
| 6. | Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 vjetëve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK) | 5 |
| 7. | Krijimi i vendeve të punës (për çdo punëtor të ri të punësuar nga një pikë, por jo më shumë se 5 pikë në total) | 5 |
| 8 | Aplikuesi qe nuk ka përfituar grant ne 3 vitet e fundit | 5 |
| | **Totali** | **100** |

9 Investimet në projekte për të përmirësuar pozitën e fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara)

a) se paku 80% e lëndës së parë të qumështit e kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;
b) se paku 30% e lëndës së parë e mishit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;
c) se paku 80% e lëndës së parë të pemëve, perimeve dhe rrushit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

(këto duhet të dëshmohen përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi)

**10** Përfituesi që ka paraparë investime në prodhimin e energjisë së ripërtërishme dhe fiton pikë për këtë qëllim, është I obliguar që këtë investim ta përdorë dhe mbajë aktiv për qëllime që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrolle nga zyrtarët e AZHB-së (ad-hoc ose ex- post) konstatohet që investimet në energji të ripërtërishme nuk janë duke u përdorur ashtu siç parashihet në biznes plan atëherë do të ndëshkohet sipas legjislacioni ne fuqi